



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 19 shtator 2017, në mbledhjen e XLIV-të (dyzetekatër) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesues Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Avni Ajeti, i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, z.Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësues të KFOR-it, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi seancën, përshëndeti të pranishmit, konstatoi prezencën dhe i njoftoi të pranishmit rreth pikave të rendit të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF e mbajtur një ditë më parë. Sigurisht që e keni vërejtur se në rend dite e kemi edhe zëvendësimin përkatësisht dhënien e betimit të këshilltarit të Komunës z.Besnik Podvorica i cili e zëvendëson ish këshilltarin z.Fidan Rekaliu i zgjedhur Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është e drejtë ligjore mirëpo unë mendoj se ju si Kryesues i Kuvendit nuk jeni njoftuar sot për këtë zëvendësim sepse ish këshilltari i Kuvendit z.Fidan Rekaliu ka më shumë se një muaj që ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit të Kuvendit të Komunës, andaj rendi i ditës është dashur të plotësohet në mbledhjen e KPF-së ku edhe është dashur t'i rekomandojmë Kuvendit për një gjë të tillë. Ne nuk jemi kundër kësaj pike të rendit të ditës, mirëpo ne si Grup nga radhët e PDK-së edhe dje ishim kundër rendit të ditës për këtë mbledhje dhe për këtë patëm dy kërkesa, andaj mendoj se nëse futet kjo pikë e rendit të ditës kërkoj të futen edhe kërkesat tona të paraqitura në mbledhjen e KPF-së, mirëpo nuk di sa janë të gatshëm drejtorët e Drejtorive përkatëse të japin përgjigje në pyetjet të cilat do të bëhen në vazhdim, e them këtë sepse nëse një drejtor nuk ka pasur përgjigje për katër vite rreth një çështje siç është kërkesa për një Informatë për gjendjen e shëndetësisë në Komunën e Podujevës, nuk besoj që do të ketë përgjigje sot në këtë mbledhje. Prandaj ne si Grup i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK-së, duke përjashtuar rastin e zëvendësimit të këshilltarit të Kuvendit sepse është e drejtë ligjore dhe këtë nuk mund ta ndalim, kërkojmë që në rend të ditës të futet edhe pika e cila ka qenë kërkesë edhe në mbledhjen e KPF-së.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e KPF-së është paraqitur një kërkesë nga znj.Kumrie Hoti për një pikë shtesë përkatësisht informatë rreth gjendjes së shëndetësisë në Komunën e Podujevës, mirëpo meqë për këtë mbledhje kemi shumë pika të rendit të ditës dhe me materiale voluminoze, jemi pajtuar që në këtë mandat ta mbajmë edhe një mbledhje ku do të përfshihet edhe kërkesa në fjalë. Po ashtu ju njoftoj se mbi 90% e Planit të punës është realizuar përkatësisht janë shqyrtuar pothuajse gati të gjitha pikat e parapara duke përfshirë edhe pika tjera jashtë Planit madje. Pra kemi një kërkesë – propozim të këshilltares së cekur, ne kemi mandat deri në konstituimin e Kuvendit të ri, kështu që mund ta mbajmë edhe një mbledhje brenda këtyre dy muajve të ardhshëm. E kamë cekë disa herë se është një rregull se në Kuvendin e Komunës, pa material të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës nuk mund të shqyrtohet asnjë pikë, andaj pikat e propozuara nga z.Rafet Llapashtica konsideroj se do të mund të shqyrtohen në një mbledhje të radhës.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, e falënderoj Kryesuesin për këto informata mirëpo nëse ne mendojmë se në këtë seancë ose në tjetrën, kështu që na shkuan 4 vite. Unë mendoj se për këtë mbledhje pikat e rendit të ditës janë shumë voluminoze, ashtu siç e ceku edhe vet Kryesuesi i Kuvendit, por si do që të jetë mendoj secila pikë e ka rëndësinë e vetë, mirëpo të kaloj një mandat dhe të mos sjellët një informatë rreth shëndetësisë në Komunën e Podujevës, nuk kam koment, andaj rreth kësaj çështjeje pres përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të jap një sqarim sepse qytetarët e Podujevës kanë të drejtë të jenë të informuar rreth informatës së kërkuar për kujdesin primar shëndetësorë. Kështu që kërkesa ime nuk ka qenë dje apo sot por ka qenë kërkesë nga viti 2013, madje është përfshirë edhe në Planet e punës së Kuvendit për vitin 2017 por që nuk është sjellë asnjëherë.

z.Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kemi vërejtur disa lëshime apo dobësi në programin e punës së Kuvendit të Komunës. në Rregulloren e Punës së Kuvendit, në nenin 87.1 thuhet, *Kuvendi e miraton Programin e Punës për vitin përkatës fiskal*, ndërsa në nenin 88.2 thuhet, *datat e caktuara për mbajtjen e mbledhjeve mund të lëvizin më së shumti 7 ditë pune*, kurse ne kemi lëvizur më shumë se 2 muaj rendin e punës së Kuvendit, gjë kjo e cila nuk është në rregull sepse kemi pasur disa pika shumë të rëndësishme për të cilat është dashur të debatojmë në muajin qershor apo në fund të korrikut, prandaj në rendin e ditës që na është sjellë për këtë mbledhje shohim se mungojnë disa pika të rëndësishme ku njëra nga to është një informatë rreth subvencionimit të klubeve sportive në Trevën e Llapit, pikë kjo e cila figuron në Planin e punës por që asnjëherë nuk është sjellë në Kuvend, informatë për të cilën mendoj se është mirë të sjellët dhe atë të jetë informatë e saktë, për arsye se kemi klube të sportit që zyrtarisht tani janë para shuarjes. Pastaj kemi të paraparë një Informatë rreth përfundimit të vitit shkollorë 2016-2017 e cila nuk është sjellë, dhe të njëjtën kohë është dashtë të kemi një Informatë rreth përgatitjeve të vitit shkollorë 2017-2018, pika për të cilat mendojmë se janë shumë të rëndësishme jo vetëm për ne si opozitë por në përgjithësi për Kuvendin e Komunës sepse të njëjtat i kemi të parapara edhe në Planin e Punës.

Po ashtu në emër të Grupit të LVV-së kërkojë që në seancën e radhës të kemi një informatë nga Drejtorati i Kompanisë e Ujësjellësit Regjional (KUR – Prishtina) rreth furnizimit me ujë të pijes, me theks të veçantë për banorët e fshatit Orllan, e them këtë sepse në bashkëbisedim me ata banorë kemi hasur në kërkesa të mëdha të tyre për furnizim me ujë të pijes, andaj drejtori i asaj Kompanie ka në kompetencë të vie këtu dhe të na informoj për

gjendjen me furnizim të ujit të pijes në rajonin e Orllanit për arsye se kemi pakënaqësi të mëdha nga banorët.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të jemi të vetëdijshëm se rreth rendit të propozuar të ditës, me Rregullore të Punës së Kuvendit nuk lejohet debat por vetëm propozime konkrete për pika shtesë apo për heqje të ndonjë pike nga rendi i ditës me arsyetime të shkurtra dhe të qarta.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, t'ju them të drejtën rendi i ditës për këtë mbledhje paksa më ka befasuar sepse mendoj se është i ngarkuar me pika të rëndësishme. Ky Kuvend e ka të aprovuar një Plan vjetor të Punës. Disa muaj nuk është takuar fare, ndërsa tani përpiqet të përmbush ato mungesa të takimeve të planifikuara, kurse sot në këtë mbledhje kemi të paktën katër pika të cilat janë bukur shumë voluminoze me rreth 400 faqe material të cilat nuk besoj se mund të trajtohen bash seriozisht në një seancë, mirëpo në qoftë se është synim që vetëm të kalohen këto pika dhe të përmbushet një detyrim ligjor që të njëjtat duhet të kalojnë në Kuvend, atëherë është krejt në rregull, por unë konsideroj se të paktën pikat 3,4,5,dhe 6 janë pika të rëndësishme për të cilat është dashur të zhvillohet debat në këtë Kuvend. Më habitën z.Rafet Llapashtica dhe z.Haki Rudari, që përse në të famshmin KPF, nuk kanë kërkuar që këto pika të ndahen dhe të mbahen dy seanca rreth këtyre pikave, dhe tani del kjo situatë që e kemi. Duke marrë parasysh se ende kemi kohë ne si Kuvend i Komunës të mbajmë edhe seanca tjera, do të kërkoja që së paku dy nga këto pika të trajtohen në një seancë tjetër të veçantë në mënyrë që të debatojmë më gjerësisht rreth tyre, përndryshe ne mund të miratojmë kështu siç janë, por nuk do të ishte e dobishme.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim. Ne për çdo vit e kemi miratuar Planin e punës së Kuvendit, dhe nëse bëjmë një analizë del se janë shqyrtuar edhe shumë tema të cilat nuk kanë qenë të parapara në Planet përkatëse. Gjithashtu që nga fillimi i këtij mandati mbledhjet janë mbajtur gjithëherë me rregull, kurse e vetmja mbledhje që nuk kemi mundë ta mbajmë, për disa arsye, është në muajin korrik të këtij viti. Të gjitha këto pika të kësaj mbledhje kanë qenë të planifikuara dhe të njëjtat kanë afate përkatëse për shqyrtim, debat dhe miratime, andaj unë mendoj se të gjitha këto pika sipas rendit të propozuar të ditës duhet të shqyrtohen sot sepse janë me rëndësi të veçantë. Sa i përket pikave të propozuara shtesë, unë do të bëjë përpjekje, por edhe do të konsultohem me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal rreth të drejtës apo jo të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, tani e tutje, nëse po, nuk ka kurrfarë problemi që ne ta mbajmë edhe një mbledhje dhe t'i shqyrtojmë ato pika që u kërkuar të përfshihen në rend dite përkatësisht që u propozuan për mbledhjen e radhës, natyrisht nëse do të mund të përgatiten.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk e di sa është i informuar kolegu z.Lutfi Rexhepi, por është e vërtetë se ne LVV dhe kolegu nga PDK në mbledhjen e KPF-së kemi propozuar që ky rend dite të ndahet përkatësisht të largohen disa pika sepse vërtetë është voluminoz, madje unë kam kërkuar edhe nga kolegët nga LDK një konsensus rreth kësaj çështje.

Çështje tjetër, i nderuari Kryesues i Kuvendit, në nenin 37.1 thuhet, *pas arsyetimit të propozuesit rreth çështjeve, kalohet në votim*, pra ne nuk po insistojmë asgjë por po kërkojmë atë temë, përkatësisht po kërkojmë të hedhet në votim se a pajtohen këshilltarët e Kuvendit që në seancën e ardhshme ta kemi një pikë të rendit të ditës, furnizimi me ujë për banorët e fshatit Orllan, andaj të hedhet në votim, kaloj apo nuk kaloj.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë e bëra një arsyetim rreth thirrjes së një mbledhje tjetër dhe e thash që do të bëjë përpjekje ta kemi edhe një mbledhje, kurse sa i përket propozimeve unë pa kurrfarë problemi i hedh në votim sepse është e drejtë e juaja, edhe pse nuk pajtohem të fusim pika të reja pa pasur materiale përkatëse.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk di ku e gjejmë në Rregullore të Punës së Kuvendit që ne në këtë seancë duhet të marrim një vendim se çka do të kemi në rend dite në seancën e ardhshme. Ne sot këtu kemi të drejtë të gjithë të propozojmë pika shtesë për rend të ditës, por jo të propozojmë pika për seancën e ardhshme. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës e harton rendin e ditës, andaj pa dashur të keqkuptohet nga ata këshilltarë të cilët kanë arsyet e tyre pse insistojnë të thërrasin seancën e radhës, është e drejta e Grupeve të këshilltarëve të thërrasin mbledhje të jashtëzakonshme nëse ndonjë pikë është urgjente dhe në interes të qytetarëve që e njëjta të trajtohet, mirëpo të propozohet respektivisht të votohet në këtë seancë për një seancë të radhës, unë nuk kam hasur askund se ka mbështetje ligjore.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e falënderoj parafolësin për sqarimet e dhëna, unë fillimisht e mendova që propozimet e këshilltarëve parafolës z.Rafet Llapashtica, znj.Kumrie Hoti dhe atë të z.Haki Rudarit t'i lë për mbledhjen e ardhshme, gjithnjë nëse kemi të drejtë ta mbajmë, ndërsa për këtë mbledhje unë sërish e them se mund t'i hedh në votim propozimet e juaja nëse ato propozime janë urgjente dhe janë të arsyeshme, mirëpo e përsërisë se pa pasur material për t'i shqyrtuar dhe për të debatuar për ato pika është e vështirë të kemi debat të mirëfilltë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, gjithherë është e drejtë të jepen propozime në mbledhjet e Kuvendit sepse nuk ndalohet me asnjë rregullore ashtu siç nuk ndalohet e drejta për të mos e votuar dhe po ashtu nuk ndalohet që Kuvendi të merr vendime dhe të jep rekomandime. Mendoj se ne në mbledhjen e KPF-së kemi qenë shumë konkret në kërkesat tona, madje ka qenë kërkesë edhe e këshilltarit z.Naim Çunakut që materiali është voluminoz dhe i njëjti të ndahet. Pastaj kur u mendua se nuk mund të hiqen pikat pa pasur një konsultim me Kryetarin e Komunës si propozues i këtyre pikave, unë e kisha qëndrimin që nëse LDK-ja nuk mund të merr vendim për t'i hequr disa pika dhe njëkohësisht të fusin në rend dite propozimet e këshilltarëve, të mbajmë një takim ne shefat e Grupeve të këshilltarëve me Kryesuesin e Kuvendit dhe me Kryetarin e Komunës në mënyrë që të renditim pikat e rendit të ditës për këtë seancë, por është e vërtetë që edhe vetë Kryesuesi i Kuvendit nuk ka shprehur disponim të detajizohet kjo çështje. Sa i përket asaj që e potencoj kolegu këshilltar z.Lutfi Rexhepi, ne në KPF kemi bërë kërkesë që edhe të ndahet rendi i ditës, por që nga subjekti LDK nuk ka pasur ndonjë qëndrim sepse nuk fliste askush madje në emër të Grupit e që një gjë të tillë do të ishte mirë ta kishim edhe në këtë mbledhje përkatësisht të del në foltore ndokush apo shefi i Grupit të LDK-së dhe të paraqet qëndrimin e këtij subjekti, e jo të dalin vetëm nga PDK e LVV.

Pra kërkesat tona janë të qarta, ose të ndahet rendi i ditës dhe t'i bashkëngjiten dy kërkesat për çështjet e caktuara, ose të vazhdohet me miratimin e kësaj seance pa marrë votat tona, sepse e keni shumicën dhe mund ta votoni, andaj i nderuar Kryesues edhe njëherë kërkoj disponimin e juaj rreth futjes në rend dite kërkesat tona apo jo, nëse nuk jeni të përgatitur për sot atëherë të del ndokush nga ju dhe të thotë atë.

Është fakt se jemi para fillimit të fushatës zgjedhore dhe kjo çështje po del sikur ne po bëjmë marketing politik, por jo i nderuar Kryesues sepse kemi të bëjmë me një kërkesë që

është edhe nevojë ngase për 4 vite këshilltarja e Kuvendit znj.Kumrie Hoti ka bërë kërkesë drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prandaj të hedhen në votim propozimet e paraqitura.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk e kërkoja fjalën me qëllim të ndonjë polemike, por nëse ndokush e merr si të tillë atëherë të mbetet ashtu, mirëpo më bëri të marrë fjalën për një sqarim. Edhe në KPF e kam thënë se kjo mbledhje nuk ka qenë mirë e përgatitur, edhe pse materiali ka qenë voluminoz, arsyeja ka qenë mungesa e drejtorëve të cilët do të mund të sqaronin çështjet përkatëse. Sa i përket materialit për këtë mbledhje parafolësi z.Rafet Llapashtica e potencoj pak më parë se ka qenë propozim i Naim Çunakut, përkatësisht i imi, mirëpo këtu kemi zyrtarët e Zyrës të cilët e bëjnë edhe incizimin e mbledhjeve dhe i gjithë diskutimi im është i incizuar dhe mund ta dëgjojmë të gjithë se çfarë kam thënë, por si do që të jetë po mundohem ta përsëriti atë që në mbledhjen e KPF-së e kam thënë sepse nuk qëndron ajo që u tha se gjoja unë kam kërkuar decidivisht të ndahet materiali ose pikat e rendit të ditës, por unë kam thënë dhe e them edhe sot që është një seancë me një material voluminoz që ndoshta nuk do të jemi në gjendje të japim kontributet tona që ish dashtë të jepen nga ana e këshilltarëve të Kuvendit, këtë e kam thënë pra, duke pasur parasysh këtë material, dhe pas diskutimit tim nuk ka shkuar mandej kjo çështje nga shefat e Grupeve rreth ndarjes apo jo të materialit. Sa i përket asaj që u tha se nuk dihet kush është shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, mendoj se nuk është diçka që duhet të merakosen Grupet tjera të këshilltarëve por është çështje të cilën duhet ta thotë Kryesuesi i Kuvendit.

Rreth thirrjes së një seance të radhës, të mos bëjmë lojë fjalësh duke përmendur pagesat apo mospagesat e këshilltarëve, gatishmërisë së këshilltarëve etj, ligji shumë qartë e përcakton që seancat e Kuvendit nuk janë pa pagesë, seanca e Kuvendit të Komunës nuk thirret vetëm sa për tu thirr, por ajo thirret duke u mbështetur në ndonjë problem shqetësues, andaj nëse kolegët në anën majtë mendojnë se ka probleme shqetësuese sigurisht që e kanë të drejtën e tyre të thirrën seancë, madje edhe sot, por mos të luajmë me fjalët duke thënë se do ta konsultojmë ligjin ngase ligji nuk e cenon të drejtën e Kuvendit dhe këshilltarëve të Kuvendit të mbajnë mbledhje, deri në konstituimin e Kuvendit të ri të Komunës, pra përderisa ne jemi këtu nën një betim nuk na cungohet asnjë e drejtë të caktojmë, thërrasim dhe të mbajmë mbledhje. Për fund, i nderuari Kryesues nëse vazhdojmë kështu njëfarë forme vetëm po futemi në rreth, por cili do që mendon se duhet të futet në rend dite ndonjë pikë, mere si propozim këtë dhe hedhe në votim, nëse kalon debatohet, nëse jo vazhdojmë me punë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe një sqarim, pati kërkesa të shtohen pika të rendit të ditës, pati kërkesa të hiqen pika ekzistuese të rendit të propozuar të ditës, unë për t'iu shmangur të gjitha këtyre paqartësive, e thashë që për kërkesat e propozuara do të bëjë përpjekje të thërras edhe një mbledhje dhe ato pika të shqyrtohen, krejt kjo me qëllim të dilet më lehtë nga kjo situatë, përndryshe unë jam i obliguar që secilin propozim që e paraqitni ta hedh në votim por të jemi më konkret. Pra për të mos krijuar situata të tilla rreth propozimeve unë isha që pikat e propozuara të mbeten për mbledhjen e radhës, mirëpo tani mund t'i paraqitni propozimet konkrete dhe unë i hedh në votim, nëse kalojnë i shqyrtojmë nëse jo vazhdojmë me punë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, unë propozoj që pika 5 e rendit të propozuar të ditës - *Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016*, dhe pika 6 - *Raporti financiar i Komunës së Podujevës*

për periudhën janar – qershor 2017, të hiqen dhe të njëjtat të jenë pika të rendit të ditës në një seancë të veçantë, konkretisht për këto dy pika të mos debatohet sot por për të njëjtat të thirret një seancë tjetër.

Çështja tjetër, këshilltarët përkatësisht anëtarët e KPF-së z.Rafet Llapashtica dhe z.Haki Rudari e thanë që këtë çështje e kemi shqyrtuar në KPF, mirëpo edhe pse unë rekomandimet e KPF asnjëherë nuk i marrë sepse konsideroj se Komitetet janë jo legjitime ngase nuk përfaqësojnë vullnetin e elektoratit të Komunës së Podujevës, në rekomandimin nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë, për çdo pikë thuhet, *Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim*, do të thotë që nuk ka asnjë propozim tjetër që ndokush ka bërë në atë mbledhje.

Po ashtu i nderuari Kryesues i Kuvendit, më lejoni t'ua tërheqë një vërejtje, përderisa ne kemi mandat, jemi kompetent të mbajmë mbledhje aq sa ka nevojë, dhe për këtë nuk keni nevojë të pyesni askënd sepse keni ligjin i cili përcakton kompetencat dhe kohën sa ne kemi mandat, dhe në këtë kontekst ne nuk mund t'ia shpëputim por as t'iu zgjatim mandatin vetvetes si këshilltarë të këtij Kuvendi.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, deri më tani unë kam ka evidentuar tri propozime, dhe atë, propozimi i znj.Kumrie Hoti dhe shefit të Grupit të këshilltarëve të PDK-së z.Rafet Llapashtica që të përfshihet në rend dite dhe një pikë shtesë përkatësisht Informatë rreth gjendjes së shëndetësisë në Komunën e Podujevës, pastaj kemi propozimin e z.Haki Rudarit i cili përcaktoj dy pika për mbledhjen e ardhshme, si dhe kemi propozimin e z.Lutfi Rexhepit i cili kërkoj të hiqen dy pika të rendit të propozuar të ditës dhe të njëjtat të shqyrtohen në një seancë, pika 5 dhe 6.

Propozim i imi ishte që ky rend dite të kaloj kështu si është propozuar kurse pikat e propozuara nga ana e këshilltarëve të shqyrtohen në mbledhjen e radhës, mirëpo unë jam i obliguar t'i hedh në votim secilin propozim – kërkesë të këshilltarëve të Kuvendit.

E hedh në votim propozimin e znj.Kumrie Hoti.

Pas votimit u konstatua se me 14 vota për, 17 vota kundër, asnjë votë të përmbajtur, nuk miratohet propozimi i znj.Kumrie Hoti për plotësimin e rendit të propozuar të ditës edhe pikën shtesë, Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për gjendjen e shëndetësisë në Komunën e Podujevës.

(edhe përkundër hedhjes në votim nuk u konstatua qartë rezultati i votimit për propozimet e z.Haki Rudarit, për shkak se i njëjti e kërkoi fjalën)

Kryesuesi i Kuvendit, fton z.Haki Rudarin të paraqes propozimet konkrete.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe njëherë në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së, propozojmë dy pika të rendit të ditës për seancën e radhës, dhe atë;

1-Informatë nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit dhe fillimit të vitit shkollor.

2-informatë nga drejtori apo Kompania e Ujësjellësit rreth furnizimit me ujë të pijes, me theks të veçantë për banorët e Orllanit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim propozimin e këshilltarit paraprak z.Haki Rudari duke përfshirë edhe propozimin e këshilltarit z.Lutfi Rexhepi, konkretisht fjala është që dy propozimet – kërkesat e z.Haki Rudarit të përfshihen në rendin e ditës në mbledhjen e radhës si dhe propozimin e z.Lutfi Rexhepit që pikat 5 dhe 6 të këtij rendi të

propozuar të ditës të hiqen dhe të njëjtat të shqyrtohen apo të përfshihen në rendin e ditës në mbledhjen e radhës.

z.Bahri Selimi, theksoi, dua të tërheqë vërejtjen se Kryesuesi i Kuvendit është duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për vetëqeverisje Lokale sepse një vendim i cili u miratua tani para 1 minute, Kryesuesi po dëshiron ta hedhë në votim edhe njëherë. Andaj nëse dëshironi ta miratoni të njëjtin vendim, duhet ta shfuqizoni atë të parin. E them këtë sepse pikat të cilat u propozuan nga shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së u miratuan paraprakisht në këtë Kuvend. Po ashtu Kryesuesi i Kuvendit paraprakisht deshi të hedh në votim njëkohësisht dy propozimet e dy këshilltarëve përkatës, ndërsa unë e them se nuk është e drejtë të hedhen ashtu sepse propozimet janë të kundërta ngase njëri ishte të hiqen dy pika kurse propozimi tjetër ishte të futen dy pika. Pra nëse dëshironi ta qitni në votim edhe njëherë propozimin e Grupit të LVV-së, paraprakisht duhet ta shfuqizoni votimin e mëhershëm.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë kërkoj të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, përkatësisht neni 37 ku thuhet, *për propozimet për plotësimin apo ndryshimin e rendit të ditës nuk hapet debat, (e që konsideroj se kjo po tejkalohet paksa nga ana jonë), por pas arsyetimeve të shkurtra të propozuesit dhe sqarimeve të Kryesuesit të Kuvendit, përfaqësuesit e Ekzekutivit apo propozuesit e çështjes konkrete, kalohet në votim.*

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, me qëllim të mos krijohen keqkuptime, sepse nganjëherë në mënyrën qysh Kryesuesi i Kuvendit po e shtron po del sikur ne nuk po dëshirojmë të debatojmë rreth tyre. Unë mendoj se isha shumë i qartë në propozimet e bëra, përkatësisht kërkoj që për pikat 5 dhe 6 të rendit të propozuar të ditës për këtë mbledhje të debatojmë në një seancë, konkretisht pikat e cekura t'i heqim nga kjo seancë e sodit që t'i bartim në një seancë të ardhshme në mënyrë që ne të mund të debatojmë ngase janë pika shumë voluminoze e që ne sot ndoshta mund t'i kapërcejmë sa për sy e faqe por jo që të japim ndonjë kontribut.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), theksoi, meqë dy pikat në fjalë të propozuara nga këshilltari z.Lutfi Rexhepi, i përkasin si propozime Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që të diskutohen në këtë mbledhje, jam për ata që ato dy pika të shtyhen për një seancë tjetër.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se tani e kemi një situatë të qartë, andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës me këto ndryshime.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i ditës, me ndryshimet si vijon:

-Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe

-Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2017, pika këto të propozuara me rend dite për këtë mbledhje, hiqen nga rendi i ditës dhe të njëjtat do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës, ndërsa pikat në vijim me numër rendor 7, 8, 9, barten sipas radhës në 5, 6, 7.

2. Verifikimi i mandatit dhe dhënia e betimit të këshilltarit të Kuvendit

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ftoj komisionin verifikues, përkatësisht z.Bahri Blakqori – Kryesues i Komisionit dhe dy anëtarët tjerë z.Flakron Gashi dhe z.Haki Rudari, që të bëjnë verifikimin e mandatit të këshilltarit të ri të Kuvendit të Komunës sipas Vendimit nr.1326-2017 të datës 27.07.2017 të Komisionit Qendror Zgjedhor për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, dhe pastaj si Komision të dalin me një raport.

Pas verifikimit të mandatit të këshilltarit të ri të Kuvendit të Komunës, në emër të Komisionit në fjalë, z.Bahri Blakqori e paraqet raportin.

z.Bahri Blakqori, theksoi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, më datë 17.07.2017 me nr.1274/2017, për zëvendësimin e ish këshilltarit të Kuvendit z.Fidan Rekaliu, në vend të tij është emëruar z.Besnik Podvorica anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

Në emër të Komisionit, këshilltarit të ri i urojmë punë të mbarë dhe suksese.

Kryesuesi i Kuvendit, pasi falënderoj komisionin në fjalë për verifikimin e mandatit të këshilltarit të ri të Kuvendit, fton z.Besnik Podvoricën të bënë betimin solemn.

Duke u vepruar në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore në fuqi, z.Besnik Podvorica jep betimin si këshilltar i ri i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

3. Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 30 qershor 2017

Pas votimi u konstatua se njëzëri, pa vërejtje u miratua Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 30 qershor 2017.

4. Propozimi i Vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës Për vitin 2018 dhe parashikimet buxhetore 2019-2020 **- Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018**

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi propozimin e vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2018 dhe parashikimet buxhetore 2019-2020, gjithashtu pjesë e projektbuxhetit është edhe propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018. Pra kemi të bëjmë me dy propozime të bashkëngjitura në një pikë të rendit të ditës ngase kështu janë disa rregulla në bazë të të cilave kërkohet të jetë pjesë e buxhetit edhe rregullorja përkatëse, andaj ftoj drejtorin e Drejtorisë për Buxhetit dhe Financave – DBF, të paraqet

një fjalë hyrëse rreth kësaj pike, pastaj vazhdojmë me diskutime sipas Rregullores së Punës së Kuvendit.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, propozim projektbuxheti i Komunës për vitin 2018 dhe projektet prioritare për vitet 2019 – 2020 është hartuar dhe propozuar duke u bazuar në legjislacionin përkatës dhe dokumentet përkatëse të Ministrisë së Financave siç janë Qarkoret Buxhetore 2018/1 dhe ajo 2018/02 e cila ka përcaktuar kufijtë final të buxhetit të Komunës për vitin 2018 në shumë 20,953,255.00€ të përbërë prej dy burimeve;

1-nga Grandi Qeveritar në shumë 19,395,641.00€, në të cilin bëjnë pjesë -Administrata Komunale në shumë 7,573,159.00€ ose 39% e grandit, -Arsim parafillor, fillor dhe i mesëm në shumë 9,199,084.00€ ose 47.43% e grandit, si dhe -Shëndetësi në shumë 2,092,382.00€ ose 13.52%, e grandit të përgjithshëm, ku siç vërehet Arsimi është shpenzuesi më i madh i buxhetit nga grandit qeveritar, ndërsa vlen të theksohet se Qendra për Pune Sociale, Drejtoria e Arsimit si dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë të financuara nga grandit i përgjithshëm i Administratës Komunale, si dhe

2-nga të hyrat vetanake në shumë 1,557,614.00€.

Ky buxhet është shpërndarë sipas instruksionit të Ministrisë së Financave, në kategori ekonomike siç janë; paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe kapitale, dhe atë si vijon:

-Për Administratë Komunale; paga 1,708,903.00€, mallra dhe shërbime 889,196.00€, shpenzime komunale 174,500.00€, subvencione 468,883.00€ dhe kapitale në shumë 5,652,291.00€ .

-Për Shëndetësi; paga 1.633,017.00€, mallra dhe shërbime 607,681.00€, Shpenzime Komunale 50.000€, Subvencione 50.000€, Shpenzime Kapitale 404,700€.

-Për Arsim; paga 8,303,740.00€, mallra dhe shërbime 420,821.00€, shpenzime komunale 100,000.00€, subvencione 40,000.00€ dhe shpenzime kapitale 432,523.00€.

Gjithashtu këtë projektbuxhet mund ta ndajmë në dy pjesë siç janë; Shpenzime operative në shumë 14.463.741.00€ dhe Shpenzime kapitale 6,489.514.00€, por vlen të ceket se tek shpenzimet operative, në kategorinë paga dhe mëditje edhe për kundër faktit se pjesa kryesore e buxhetit shkon për atë kategori prap se prap ky buxhet nuk është i mjaftueshëm në sektorin e arsimit, mungesë kjo e paraqitur edhe në propozim vendimin e Kryetari të Komunës për projektbuxhetin e vitit 2018, me shprese që MF do ta rregulloj këtë deri në miratimin e buxhetit nga Kuvendi i Kosovës. Po ashtu vlen të ceket edhe kategoria e subvencioneve ku edhe përkundër buxhetit të vogël, kemi ndarë 40,000.00€ për bursa, 60,000.00€ për shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, 60,000.00€ për kulturë rini dhe sport, si dhe 305,233.00€ për bujqësi, shuma këto të cilat janë përcaktuar sipas MF me rastin e caktimit të kufijve final të buxhetit të Komunës nëpër kategori ekonomike me ç'rast ka bërë shkurtime në kategorinë e subvencioneve nëse e krahasojmë me Kornizën Afatmesme Buxhetore, planifikimi ka qenë 698,883.00€ që do të thotë se kemi një zvogëlim të imponuar nga MF me një vlerë prej 130,000.00€ e cila ka ndikuar negativisht në planifikimet tona në bujqësi.

Në projektet e propozuara sipas listës përkatëse, kemi pasur parasysh një shtrirje të gjerë territoriale në Komunën e Podujevës dhe duke bërë përpjekje maksimale që t'i plotësojmë sa më shumë nevojat e qytetarëve marrë parasysh gjithnjë kërkesat dhe nevojat e tyre që janë shumë më të mëdha.

Ky propozim projektbuxhet është përgatitur sipas programeve të Komisionit Evropian BDMS ku janë futur të dhënat për shpenzime operative për vitin 2018 si dhe projeksionet për vitet 2019-2020 njëkohësisht edhe planifikimi i të hyrave vetanake, si dhe programi PIP-sitem ku janë futur projektet kapitale në detaje duke përfshirur të gjitha të dhënat e nevojshme për secilin projekt.

Të nderuar, pjesë përbërëse e këtij propozim buxheti për vitin 2018 është edhe propozim Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018 e cila nuk ka pësuar ndryshime sa i përket elementeve kryesore siç është norma e tatimore e cila është minimale dhe fillon me 0.15% deri në 1% për objektet e banimit si dhe tek bizneset nga 0.20% deri në 1%. Ne kemi propozuar 0.15% dhe 0.20% duke konsideruar si norma të cilat janë të përballueshme për qytetarë dhe biznese.

Po ashtu vlen të theksohen ndryshimet sa i përket kësaj propozim rregullore, në rregulloren aktuale figuron një lloj i pronës së braktisur vlerësuar me një vlerë të caktuar, ndërsa në propozim rregulloren në fjalë për vitin 2018 është hequr tërësisht, si dhe ndryshim tjetër është tek adresat me ç'rast janë hyrë emërtimet e reja të rrugëve.

Për fund, të nderuar këshilltar/e të Kuvendit, projektbuxheti i Komunës është një nga dokumentet më të rëndësishme që miraton ky Organ dhe që është drejtpërdrejt i lidhur me qytetarët e Komunës së Podujevës, prandaj ju ftoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, para se të vazhdojmë me punë, ju njoftoj se në mbledhje të pranishëm nuk është këshilltari i Kuvendit z.Avni Ajeti. Këtë mungesë nuk e kam vërejtur në fillim të mbledhjes, andaj kjo të mbetet për konstatim të pjesëmarrjes.

z.Hasan Softolli, theksoi, Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah propozim projektbuxhetin e Komunës për vitin 2018 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2019-2020. Karakteristikë e këtij projektbuxheti është se vërehet një ngritje e buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale e që nënkupton se Komuna e Podujevës do të ketë projekte më të mëdha në qeverisjen e ardhshme, duke mos dashur t'i përmendi me radhë konsideroj se të gjitha projektet e parapara do të jenë të mirëseardhura për qytetarët e Komunës së Podujevës, siç janë dhe që vlen të theksohen, fillimi i ndërtimit të shesheve të qytetit, fillimi i ndërtimit të bulevardit, ndërtimi i parkingut nëntokësor si dhe shumë projekte tjera në fushën e shëndetësisë, bujqësisë dhe në të gjitha sferat tjera pa dallime.

Gjithashtu ne e përkrahim edhe propozim rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018, e cila është e hartuar në bazë të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi. Ky propozim ka caktuar vlera të tregut për m² për katër Zonat përkatëse ku edhe është caktuar tarifa për m².

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë personalisht por edhe moralisht nuk mund të pajtohem, madje mendoj që as këshilltarët e LDK-së nuk do të mund të pajtohen moralisht, kurse politikisht ndoshta po, me specifikimet e projekteve që janë propozuar në këtë projektbuxhet të Komunës për vitin 2018 dhe parashikimet për 2019-2020, e them këtë ngase, shembull, në arsim drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Avni Maloku ka paraparë që në vitin 2018 të ndërtoj shkollë në fshatin Llaushë, pastaj sërish ceket ai projekt për vitin 2019, ndërsa nxënësit e atij fshati nuk e dinë se kur do të futen në objektin e ri, më 2018 apo në vitin 2019, gjë të cilën nuk e din as vet drejtori, ashtu siç nuk është ndërtuar shkolla "Dituria" në fshatin Llapashticë e që ky Kuvend ka ndarë mjete nga të hyrat vetanake për ndërtimin e asaj shkolle, pastaj i ka ndarë mjetet për hartim të projektit, kurse tani jemi në muajin shtator dhe mësimi ka filluar, ndërsa dje isha në atë fshat ku deri më tani ishin ndërtuar

vetëm themelet e shkollës, çështje për të cilën mendoj që ose nuk ju janë lëshuar mjetet financiare dhe ato janë orientuar dikund tjetër ose nuk ka përgjegjësi juridike të Drejtorisë përkatëse. Tek Urbanizmi, jam shumë i sigurt që asnjë këshilltarë i Kuvendit nga asnjë subjekt politik, me përjashtim të Ekzekutivit të Komunës, nuk mund të shkoj në ndonjë lokalitet të caktuar dhe t'iu tregoj banorëve se kjo apo ajo rrugë do të asfaltohet ngase nuk janë specifikuar, shembull, në fshatin Bradash janë paraparë disa rrugë për asfaltim por që asnjëri prej neve nuk është në dijeni për cilat rrugë bëhet fjalë, madje ka qenë kërkesë e kahmotshme e kolegut këshilltarë z. Islam Revuçit për asfaltim të një rruge i cili që katër vite ka parashtruar kërkesë në KPF dhe në këtë Kuvend e që ende nuk është rregulluar kurse tani sërish është përfshirë në këtë projektbuxhet ajo rrugë përkatësisht Lagja Revuçi në fshatin Bradash. Problem tjetër është se nuk mund të pajtohem me projektin dhe strategjinë që e ka bërë Ekzekutivi i Komunës, vetëm analizojeni se si ka planifikuar Ekzekutivi të rrisë zhvillimin ekonomik në Komunën e Podujevës në vitin 2018 ku më shumë kushton kostoja e pagave të zyrtarëve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik se sa buxheti i kësaj Drejtorie sipas së cilës mendohet të zhvillohet një Komunë me rreth 100 mijë banorë, pastaj është paraparë sërish ndërtimi i shtigjeve për biçikleta te parku i qytetit, shtroj pyetje, çfarë mendoni se me këtë ndërtim Komuna e Podujevës do të zhvillohet ekonomikisht, kurse unë mendoj se ato hapësira mund të bëhet rekreacion, jetë më e mirë, sportivitet etj, por ekonomia nuk ritet me atë shteg të biçikletave, apo siç kemi projektin e paraparë për ndërtimin e shtigjeve për ecje tek pishat e fshatit Kërpimeh, projekt ky i paraparë që 4 vite, e që mendoj se asnjë lloj zhvillimi ekonomik por as asnjë cent inkasim ose e hyrë e Komunës nuk do të ndodh me ndërtimin e atyre shtigjeve, pra ky është plani strategjik i Drejtorisë në fjalë që ta ngritë zhvillimin ekonomik në Komunën e Podujevës. Seriozisht e them që është shumë mirë që nuk ka ndonjë TV lokale sepse do të kalonim në nivele shumë të ulëta kur qytetarët do të dëgjoshin se çka ka këtu, si dhe mendoj që duhet pasur shumë durim edhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës të debatojnë rreth këtij projektbuxheti i cili është sjellë këtu. Në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së jam kundër dhe kundërshtojmë fuqishëm planin e Drejtorisë në fjalë e cila ka paraparë që zhvillimi ekonomik do të ndodh me ndërtimin e dy shtigjeve për ecje dhe për biçikleta, si dhe me pritshmërinë se një shkollë do të ndërtohet në vitin 2018 apo në vitin 2019 në fshatin Llaushë. Kur flasim për shkolla nuk mund të anashkaloj faktin se në fshatrat Zhiti dhe Sylevicë është mbyllë shkolla dhe nxënësit e atij fshati nuk vijojnë fare mësimet kurse drejtori i Drejtorisë së Arsimit rrinë me krevatë ulur këtu së bashku me mua dhe i tregojmë njëri tjetrit se është duke u qeverisur mirë në Komunë apo jo.

Mendoj se fillimisht është obligim i Grupit të këshilltarëve nga Lidhja Demokratike e Kosovës e pastaj i Ekzekutivit të Komunës që të del dhe të tregoj se kur do të ndërtohet shkolla në fshatin Llaushë dhe të shprehë qëndrimin e vet lidhur me parashikimet e Drejtorisë për atë shkollë, pastaj kur do të përfundoj ndërtimi i shkollës "Dituria" në fshatin Llapashticë dhe ku janë mjetet e miratuara në këtë Kuvend për hartimin e projektit dhe ndërtimin e asaj shkolle, kur do të fillojnë mësimin nxënësit e fshatit Sylevicë, përse është mbyllur ajo shkollë dhe çfarë hapash janë marrë deri tani. Pra këto janë disa tema që nuk mund të tejkalohen

Mua do të më vinte vështirë po të isha në vendin e juaj dhe të procedoja një projektbuxhet të tillë në bazë të të cilit Komuna e Podujevës do të zhvillohet ekonomikisht me ndërtimin e dy shtigjeve për ecje dhe për biçikleta, kështu që para se të hedhet në votim secili nga

ne duhet të mendoj se a duhet apo jo të kaloj ky projektbuxhet, qoftë si pikë e veçantë çoftë si tërësi për vitin 2018.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht që edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e kemi analizuar këtë propozim projektbuxhet dhe ajo që u cek edhe nga një koleg parafolës e që realisht konsiderohet element pozitiv është ngritje e buxhetit për investime kapitale, mirëpo megjithatë i kundërshtojmë projektet e parapara në këtë projektbuxhet dhe kemi vërejtjet tona ngase prej një buxheti prej 20.953.255.00€ në total sa është dhe prej shpenzimeve kapitale në shumë 6.489.514.00€, kurse në të njëjtën kohë nëse dalim në terren shohim se kemi projekte të cilat qytetarët i kanë sjellë që nga viti 2014 dhe të cilat nuk janë përfshirë në projektbuxhet tregon për diçka shumë jo serioze dhe tejet negative. Unë në emër të Grupit vazhdimisht i kam përkrah investimet mirëpo kam kundërshtuar investimet në baza partiake dhe këtë e them edhe sot haptas në mënyrë fikse se buxheti është i qytetarëve e jo i partive politike. Në vizitat që kemi bërë ne si LVV kemi hasur se në fshatin Buric projekti është bërë në vitin 2014 por i njëjti nuk është implementuar fare.

Më 17.09.2017 me kërkesë të qytetarëve kemi vizituar fshatin Majac dhe janë paraqitur kërkesa të shumta, prej ulice deri tek retkocerët dhe prej berishve deri tek krysyra janë pa asfalt, projekti është bërë por i njëjti është kthyer nga Komuna, nuk është gjë e mirë kjo sepse buxheti është i të gjithëve, prandaj nuk pajtohem me këtë formë të investimeve sepse ato realizohen me logjikën "vetëm aty ku janë përkrahës të subjektit tonë"

Më 07.09.2017 kemi pasur një takim zyrtar me drejtorë të sindikatës së arsimit në Podujevë z.Fadil Halimi dhe z.Ragip Gashi, me temë, implementimi i Kontratës Kolektive të nënshkruar më 18.04.2016 në mes MASHT dhe SBASHK, ku nga ai takim ka dal se kemi obligime nga qeveritë komunale dhe unë tani jam i autorizuar t'i paraqesë në qeverinë komunale këtu ku jemi, pra obligimet komunale janë; dhënia e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, pastaj 2 € në emër të shujtës për çdo ditë të udhëtimit dhe 70% të shumës së biletave për punëtorët e arsimit të cilët udhëtojnë, pra këto janë obligime të dala nga Kontrata në fjalë dhe mendoj se me këto kontrata nuk duhet të bëhen lojëra mediatike dhe elektorale sepse në realitet humbin të gjitha partitë politike por natyrisht se në rast implementimi fitojnë të gjitha partitë, kontratë të cilën kanë filluar ta zbatojnë vetëm dy komuna deri tani.

Kthehemi tek projektet për vitin 2018 ku sërish e kemi një investim prej 950,000.00€ për ndërtimin e bulevardit dhe sheshit të Dëshmorëve, e që ne e kemi kundërshtuar sepse është marre dhe turp për ne që ende nuk kemi shesh të Dëshmorëve, dhe për këtë unë personalisht po ndihem keq para qytetarëve për faktin që ende nuk kemi shesh të Dëshmorëve. Çështje tjetër është mos specifikimi i projekteve dhe kjo më brengosë shumë, dhe pyes përse bëhet kjo dhe përse nuk ceken rrugët ose lagjet, madje vazhdohet me këtë praktikë. Në numrin 28 thuhet, asfaltimi i rrugëve në disa fshatra, Dobërdol, Majac, Merdar, Kushevicë, Batllavë, Dyzë, Herticë, Surdull në shumë 15,000.00€, shumë me të cilën nuk di se si mund të asfaltohen rrugë në gjithë këto fshatra, kur kemi parasysh se fshati Surdull dhe disa tjera janë të thella dhe vetëm investime mund t'i ndalin banorët e tyre të mos zhvendosen. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike kemi zgjerimin dhe rregullimin e shtratit të lumenjve, e që është mirë të specifikohen për cilët lumenj bëhet fjalë sepse lumin Dumnica e kemi në gjendje jo të mirë, pastaj kemi zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në shumë 45,000.00€, shumë për të cilën kemi vërejtje dhe propozojmë që kjo të rritet sepse ka shumë vende që nuk kanë ujë të pijes siç është rasti i banorëve të fshatit Llapashticë të

cilët kanë ankesa dhe madje ankohen se kanë mungesë të ujit të pijes edhe në shkollë, prandaj konsideroj se kjo shumë e paraparë është mjaft e vogël sepse Llapi është i gjerë, e që shuma e cekur ndoshta mund të jetë e vogël edhe për një fshat të vetëm madje, por meqë në mbledhjen e ardhshme sipas të gjitha gjasave do të debatohet për këtë çështje është mirë ta kemi parasysh këtë. Po ashtu kemi të paraparë shumën prej 40,000.00€ nga të hyrat vetanake për ndërtimin e stacionit të udhëtarëve, a mund të bëhen specifikime dhe sqarime më të qarta. Meremetimi i rrugëve me zhavorr, ka ankesa të shumta me theks të veçantë në fshatin Dyz është një rrugë e pakalueshme të cilën edhe vet personalisht e kam vizituar ku banorët e asaj lagjeje thonë se Komuna nuk na është dal në përkrahje.

Sa i përket rregullimit të hapësirave publike në shumë 50,000.00€ po ashtu nuk ka specifikime se për cilat hapësira bëhet fjalë andaj është mirë ta dimë se ku janë. Tek Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ashtu sikurse më parë edhe tani kam pyetje rreth një investimi në shumë prej 84,000.00€ për të cilin thuhet, participim me donatorë në projekte të ndryshme, a mund ta dimë se cilat janë ato projekte ngase ne po i përkrahim projektet por dëshirojmë të njoftohemi se a ka projekte apo vetëm ashtu eventualisht mund të vijnë projekte, gjë e cila po përsëritet dhe për këtë kemi vërejtje ashtu siç kemi vërejtje edhe për përsëritjen e planifikimit në shumë 10,000.00€ për studimin e fizibilitetit të studimin për zhvillimin e turizmit në Komunën e Podujevës, gjë për të cilën mendoj se është dashur më herët të bëhet ky studim i fizibilitetit kurse tani është dashur veç të kemi projekte për zhvillim të turizmit. Sërish e përsërisë se kërkesat e banorëve të fshatrave janë të shumta, siç janë ato të fshatrave të Gallapit, Orllanit, pastaj banorët e fshatit Dobratin po ashtu kanë kërkesa të shumta prandaj në këtë drejtim është dashur më shumë të investohet e jo të ndahen shuma për studime të fizibilitetit pa pasur projekte.

Tek Drejtoria e Bujqësisë kemi një shumë të paraparë prej 300,000.00€ e cila mendoj se duhet të rritet, por vërejtje e imja në vazhdimësi është që ndarja e subvencioneve të ndahet në bazë të kriterëve, dhe kjo është e evidentuar edhe në raportin e auditimit. Tek Drejtoria e Arsimit po ashtu kemi vërejtje sepse kemi të ndara rreth 200,000.00€ për ndërtimin e shkollës në fshatin Llapashticë, andaj mendoj se nuk duhet të futen vetëm projekte në bazë të logjikës për të fituar vota për arsye se vërtetë ata nxënës po pësojnë ashtu siç është rasti edhe i nxënësve të fshatit Batllavë të cilët po rrinë nëpër shtëpitë e tyre për arsye të mos funksionalizimit të shkollës, prandaj e them se duhet të jemi shumë më fleksibil dhe më korrekt në vendosjen e projekteve. Në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport serish kemi të paraparë shumën prej 90,000.00€ për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës por konsideroj se me ndryshimin e përbërjes së qeverisjes lokale ai projekt në mandatin e ardhshëm do të ndryshohet. Gjithashtu dëshiroj të shtroj një pyetje rreth ndarjes së shumës 10,000.00€ për zërim profesional, gjë e cila më duket shumë e paarsyeshme. Po ashtu për ndërtimin e fushave të hapura sportive në shumë 78,497.00€ nuk ka specifikime dhe nuk di se për cilat lokacione bëhet fjalë. Ne si Grup nga radhët e LVV-së kemi edhe propozimet tona të cilat i kemi dhënë më parë por për të cilat drejtori i DBF vazhdimisht ka thënë se nuk kemi mjete financiare, andaj përse nuk i merrni për bazë edhe ato propozime sepse nga to përfitojnë edhe LDK edhe LVV.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, më bëri të marrë fjalën reklama e LDK për të mirat që i ka bërë në Komunën e Podujevës e për të cilat shpresoj të jenë të vërteta por ato as përgjysmë nuk janë të vërteta dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë. Gjatë këtij mandati vazhdimisht kam kërkuar të asfaltohen rrugët në fshatin Revuçë, gjë që banorët e atij fshati janë obliguar të hartojnë projektin i cili ka kushtuar rreth 4600.00€ edhe pse kemi qenë në dijeni të gjithë

se Komuna është e obliguar të hartoj projektet për rrugë, kurse edhe përkundër kësaj edhe sot nuk janë asfaltuar ato rrugë. Për këtë e dimë pse dhe qysh, por tani jemi në fushatë dhe shfrytëzohen ato rrugë sekondare të shtrohen më datë 21 tetor, kështu që jemi të përgatitur ne si qytetarë për këtë lojë të cilën e bënë LDK-ja. Çështja tjetër e cila më bënë të brengoset është lagja Merovci për të cilën me sinjeritetin më të madh i drejtohem drejtorit përkatës i cili edhe është në dijeni për ato familje të cilat janë në gjendje të mjerueshme, e që nuk ka qenë vullneti që të paktën atë rrugë ta shtroni me 4 kamion me zhavorr. Unë mendoj se është një përgjegjësi dhe një keq menaxhim i kësaj qeverisje të cilës mendoj se i ka ardhur fundi.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, në fakt ka bukur shumë gjëra të cilat meritojnë mbështetje në këtë projektbuxhet siç është e-kioska që në fakt jemi vonuar, pastaj tek Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik funksionalizimi i zyrës për menaxhimin e projekteve të Partneritetit Publiko Privat – PPP si dhe gjëra tjera të cilat mendoj se i takojnë subjektit – pozitë të lavdëroj ato, mirëpo nga aspekti opozitar që jam më duhet të merrem me çështje të cilat mendoj se janë jo të mira. Fillimisht sa i përket shtigjeve për biçikleta dua të ndaj mendim me shefin e Grupit të këshilltarëve nga subjekti që i takoj dhe unë, mua më vie mirë që janë paraparë shtigje të tilla dhe konsideroj se janë të pakta sepse është dashur të ketë më shumë ashtu siç është dashur të ketë më shumë projekte për ndërtimin – rregullimin e këndeve të ndryshme për fëmijë, kënde të lojërave, më shumë hapësira gjelbëruese, pastaj është dashur që drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR i cili këtë mandat ky Ekzekutiv e ka filluar me 450,000.00€ për subvencione, kurse tani është zbritur në 300,000.00€ e që realisht unë kam pritur që të paktën të rritet për 50% e vlerës prej të hyrave vetanake të jetë e planifikuar pikërisht për subvencione sepse vërtetë është një mundësi e mirë për ndikim në zhvillimin direkt ekonomik. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit asfaltimin e rrugëve e ka filluar me fshatin Bradash e që unë realisht kam menduar se ai fshat këto punë i përfunduar më përpara, mirëpo sinjerisht dhe pa anime politike ju lus që të respektohet më shumë gjeografia sa i përket investimeve, sa për shembull do të përmend një apo dy raste, në pjesën e sipërme të fshatit nga vie unë Llapashticë kanë qenë disa familje (Kodralitë) të cilët në mungesë të investimeve e kanë lëshuar të gjithë atë vend dhe më nuk është asnjë familje atje por të gjithë janë shpërndarë, një pjesë e tyre kanë mbetur rreth 17-18 shtëpi të cilët vërtetë e kanë jetën të rëndë dhe është për gjynah se si kanë mbetur në atë gjendje si janë, pastaj është një lagje tjetër e cila nga banorët njihet si Lagja Nelakët të cilët po ashtu janë duke u shpërngulur sepse asnjë investim nuk është bërë në atë pjesë madje asnjë lopatë me zhavorr po thuajse, dhe ashtu siç ka filluar nuk do të jetë kohë e largët kur të gjithë ata do të shpërngulen, përkundër asaj që patën filluar të merren me disa biznese, ferma të lopëve, për të mbijetuar, mirëpo për shkak të mos investimeve në infrastrukturë, si duket edhe ata banorë do të braktisin atë vend. E vërteta është se infrastruktura në vetvete nuk është zhvillim, por është parakusht për zhvillim sepse pa të nuk mund të bëhet dhe është mirë që këto gjëra tani veç po vijnë duke u rrumbullakësuar, mirëpo është mirë të bëhet një ndarje buxhetore më gjithëpërfshirëse, e jo vetëm në ato vende ku merren votat edhe pse e kuptoj edhe atë pjesë, por të mbetet diçka edhe për të tjerët që është edhe nevojë, fundja këto janë çështje edhe paksa humane, njerëz jemi dhe nuk është shumë me rëndësi kush ku jemi por të mos lihen këto gjëra pas dore.

Kërkoj nga drejtori z.Avni Fetahu, të kërkoj dhe të jetë më këmbëngulës sa i përket buxhetit për subvencione sepse është treguar si një fushë e cila u mundëson familjeve të krijojnë

biznese familjare dhe që mund të jetë një parakusht që të kalohet në fazën sekondare që gjithë të tjerët kanë shkuar nga zhvillimi. Nuk di përse ndërtimi i shtëpisë së kulturës po bartet nga viti në vit kurse shtëpi të kulturës ende nuk kemi, si dhe nuk di përse po planifikohen apo thënë ndryshe nganjëherë më duket se këto gjëra po i bëjmë vetëm sa për të përmbushur një çështje formale sepse pastaj po ndodh të barten projekte të ndryshme, madje edhe nga mandati në mandat. Mua si qytetarë i Podujevës më vie keq që nuk e kemi një shesh tamam urban ku do të mund të dilnim me familje për të shëtitur, më vie keq që në Komunën tonë, jo pse jam ndonjë patriot, nuk e kemi asnjë statujë të Dëshmorëve apo Heronjve tanë, edhe pse kemi marrë vendime më shumë se njëherë në këtë Kuvend, madje mbaj mend që kur është ndërtuar sheshi këtu afër Komunës dhe i cili është vonuar me punime, arsyetimi i ish Ekzekutivit të Komunës ka qenë se gjoja janë duke pritur disa pllaka më të mira se sa ato që janë planifikuar, e që në fakt sot del se nuk kanë qenë të mira dhe që ende mbetet i papërfunduar në tërësi, pastaj mua më vie keq që në atë bazament nuk qëndron Shtatorja e Heroit për të cilin ky Kuvend ka marrë vendim për një gjë të tillë, dhe nuk më bënë të ndihem shumë mirë kjo gjendje.

z.Flakron Gashi, theksoi, nuk është hera e parë por është bërë praktikë që evidentimi në letër i projekteve ka kaluar si farzë për realitetin qytetarë sidomos në qendër të qytetit. Tek përshkrimi i projekteve prioritare për vitin 2018, në renditjen numër 4 thuhet, zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Zahir Pajaziti" dhe rrugës "Skenderbeu" në qytet me tërë infrastrukturën përcjellëse të kërkuar si, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjet nëntokësor të instalimeve elektrike internet – telefon, instalim i gypave nëntokësor për ngrohjen qendrore të qytetit etj. dhe shuma është 304,000.00€, kjo është mu tallë me banorët të cilët jetojnë pranë ose në lagjet e këtyre pjesëve të qytetit ngase me 304,000.00€ as 4 shtëpi me këtë standard nuk mund të ndërtohen, mandej nëse zgjerohen rrugët "Skenderbeu" dhe "Zahir Pajaziti" ku do të mbesin trotualet, a do të rrëzohen shtëpitë ose si janë planifikuar. Tjetër, ndërtimi i bulevardit dhe sheshit, Sheshi i Dëshmorëve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushevci – Ali Ajeti në qendër të qytetit vazhdim, të nderuar këtu është bërë një bashkëdyzim sepse bëhet fjalë për dy sheshe, ekziston një vendim i Kuvendit për Sheshin Ali Ajeti i cili nuk është zbatuar në tërësi por ka mbetur në gjysmë, është për t'keq, për gjynah dhe për keqardhje si qyqe e rremit, si dhe sheshi tjetër i cili e ka vetëm emrin dhe ka stalaktite aty dhe bubashpaga të hekurit por nuk ka Shtatore të Dëshmorëve, vendim i cili është marrë në këtë Kuvend në vitin 2012, ndërsa këtu flitet për një bulevard dhe tani shtrohet pyetja, ku do të mbetet Sheshi Ali Ajeti, ku do të mbetet Sheshi i Dëshmorëve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushefci – Ali Ajeti, a do të mbyllet rruga komplet, a ka projekt të hartuar dhe a janë pajtuar qytetarët se si duket ky projekt i cili e kap shifrën e rreth 1 milion eurove, si dhe mos të harrojmë se ne kemi vënë një plan se si do të duket pjesa urbane e Zonës Qendër, dhe nëse ai plan ende nuk është aprovuar në Kuvend, si mundemi të planifikojmë mjete për ndërtimin e shesheve, njëkohësisht ai plan prek edhe pjesë të caktuara të dy rrugëve të sipërpërmendura, andaj e them se kjo është tallje, dhe mua më vie keq që sot jam në këtë sallë dhe bëhet pazar me interesat e qytetarëve të cilët jetojnë në qendër të qytetit, pra është tallje. Qindra mijëra euro janë ndarë për zona dhe për rrugë të qytetit kurse sot në qendër por edhe gjithandej qytetit ka gropa deri në 30 cm. dhe me këtë besoj se pajtohen edhe kolegë të cilët janë pjesë e Ekzekutivit të Komunës, ose marrim çështjen tjetër, parashikohet që në vitin e ardhshëm të zgjerohet rruga "Skenderbeu" ndërsa tani investohet me një shtresë të re të

asfaltit nga Hotel Besiana, gjë e cila i bie me luajt me taksa të qytetarëve, nuk ka diçka reale e as konkrete.

Çështje tjetër, tek Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, ka qenë një premtim i Kryetarit Veliu që nuk e ka mbajtur, ka thënë do të q'rrënjosim varfërinë dhe do ta zhvillojmë Podujevën ekonomikisht, kurse mjetet të cilat janë ndarë dhe janë planifikuar për këtë Drejtori në vazhdimësi në këtë mandat, nuk janë as përsëafërmi dhe nuk plotësojnë nevojat dhe kriteret të cilat do të duheshin të ngritnin zhvillimin ekonomik lokal dhe madje është në përgjegjësi. Tek projekti për funksionalizimin e zyrës për menaxhimin e projekteve zhvillimore me Partneritet Publiko Privat në shumë 10,000.00€, i bie që kjo zyrë ka ekzistuar por është dashur të pritët 4 vite për një shumë prej 10,000.00€ për tu funksionalizuar, ndërsa tek Drejtoria e Administratës thuhet blerja e një E-kioske në vlerë 8,000.00€, kurse ne të gjithë shohim një aparaturë e cila qëndron para objektit të ri të Komunës dhe nëse bëhet fjalë për atë i bie që aparatura është aty, por pagesa do të bëhet në vitin 2018 ose bëhet fjalë për instalimin e saj, do të doja më shumë informatë rreth kësaj. Po ashtu në këtë propozim projektbuxhet kemi edhe prioritetet për vitin 2019 ku sërish figuron projekti për ndërtimin e Bulevardit dhe sheshit Sheshi i Dëshmorëve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushefci – Ali Ajeti , në qendër të qytetit, vazhdim, nuk kam shikuar ndoshta i njëjti figuron edhe në vitin 2020, Nuk dëshiroj vetëm pse e kam mundësinë të dal të flasë dhe atë jo vetëm sot, por nga dita që kam marrë mandatin dhe kam dal në këtë foltore nuk jam dhe nuk e heq asnjë pikë dhe asnjë presje çka kam thënë në këtë foltore, kushdo që mendon të kundërtën le të urdhëroj tek organet gjegjëse dhe do ta provojnë të vërtetën.

z.Bahri Selimi, theksoi, e than shumë qartë edhe para folësit, por edhe unë mendoj se problemi më i madh që është tek Korniza Afatmesme Buxhetore është shpërndarja e projekteve. Se si ndahen projektet dhe si shpërndahen ato e kemi diskutuar shumë herë dhe pothuajse është avaz i vjetër dhe po vazhdon me të njëjtin avaz edhe sot. Shpërndarja e projekteve nëpër fshatra të njëjta me ç'rast kemi fshatra në të cilët janë të asfaltuara edhe rrugë (të arave) dhe të cilat frekuentohen vetëm me mjete bujqësore kur bujqit shkojnë për të punuar tokat e tyre, përderisa ka fshatra tjera të cilët edhe rrugët që i frekuentojnë për çdo ditë i kanë të mbyllura nga therrat dhe nga mbeturinat dhe që janë të pakalueshme e që për hir të transparencës unë në vazhdim do t'i përmend edhe me emra, shembull, nëse shkojmë në fshatin Bradash dhe shikojmë rrugët e asfaltuara dhe krahasojmë disa rrugë në fshatin ku jetoj unë vërtetë po ndihem keq. Unë edhe në diskutimin e parë për Kornizën Afatmesme Buxhetore i kam ngritur disa çështje rreth shpërndarjes së buxhetit nëpër Drejtori, kam menduar se do të ndryshoj diçka nga ai dokument por realisht nuk është ndryshuar asgjë, pra edhe atëherë kam thënë dhe po e përsëris sërish se 80% e buxhetit për shpenzime kapitale 6,489,514.00€ është i ndarë në dy Drejtori, në atë të Urbanizimit dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që do të thotë se 80% e buxhetit për vitin e ardhshëm por edhe për dy vitet tjera janë të ndara në asfalt dhe në kanalizime, më saktësisht 3,061,562.00€ ose 47.1% janë të ndara në Drejtorinë e Urbanizimit, kurse në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë të ndara 2,180,682.00€ ose 33.6%, pra këto dy Drejtori thithin rreth 80% të buxhetit për investime kapitale gjë e cila na bënë të shprehim pakënaqësi ngase 80% e buxhetit shkon vetëm në dy dikastere përkatësisht në rrugë dhe kanalizime. Po ashtu është shqetësuese që tek Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ku nga i tërë buxheti për vitin e ardhshëm janë të ndara vetëm 140,000.00 € ose 2.15%, andaj nuk di si do të mund të bëjë zhvillim ekonomik kjo Drejtori në Komunën tonë

me këtë buxhet, dhe nuk e di përse kjo Drejtori nuk ka kërkuar më shumë buxhet për tu munduar ta funksionalizoj zonën industriale e cila shumë kohë më përpara është miratuar por që nuk është bërë asnjëherë, si dhe qysh mund të ketë zhvillim ekonomik në Komunën e Podujevës si më e madhja me territor kur nuk kemi zonë industriale.

Sa i përket bujqësisë, ne po thirremi se në rajonin e Llapit ka marrë një jehonë të madhe, si mundemi ne të stimulojmë bujqit dhe t'iu japim mundësi atyre që ta vazhdojnë apo të zhvillojnë bujqësinë, me 4.70% të mjeteve të ndara nga ky buxhet që i bie 305,233.00€ nga buxheti i përgjithshëm. Tek Drejtoria e Shëndetësisë, mendoj se për gjendjen e shëndetësisë në Komunën e Podujevës tani më veç jemi në dijeni të gjithë sepse të gjithëve pothuajse na paraqitet nevoja të kemi vizita në objektet shëndetësore, dhe të gjithë jemi në dijeni se ka objekte të cilat kanë filluar të prishen për shkak të mos funksionalizimit të tyre, dhe në fund për këtë Drejtori ndahen 404,700.00€ që i bie 6.23% e buxhetit. Unë po i kalkuloj këto shuma dhe përqindje sepse kur e mendon 47% -in në një dikaster kurse në një dikaster tjetër shumë të rëndësishëm dhe me shumë peshë për shëndetin e qytetarëve Llapjan janë vetëm 6.23%, për mendimin tim është marramendëse dhe e pakuptueshme. Tek Drejtoria e Arsimit, po ashtu është një ndarje shumë e vogël e buxheti, u fol këtu për ndërtimin e disa objekteve shkollore, por infrastruktura në të gjitha shkollat është marramendëse, të paktën në ato të cilat po kam mundësi të vizitoj gjendja është katastrofale, madje në shekullin 21 ka shkolla të cilat tualetet i kanë ndoshta 100 metra larg nga objekti. Po ashtu për mendimin tim është shqetësuese që tek Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë për vitin e ardhshëm ndarja e buxhetit është 0%, do të thotë se nuk është ndarë asnjë centë për këtë Drejtori, ndërsa ne jemi në dijeni qartë se menaxhimi i pronave publike bëhet nga kjo Drejtori. Pronat publike në Komunën e Podujevës nuk menaxhohen fare, prandaj të mos jetë në gjendje drejtori i kësaj Drejtorie që nga mbi 6 milion euro sa janë për investime kapitale, të ndaj një shumë, të hartoj një plan për menaxhimin e pronave të cilat sjellin të hyra vetanake për Komunën, unë edhe me këtë nuk di si mundet dhe mendohet të shpenzohet dhe ndahet buxheti drejt.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës kemi vërejtje sepse nuk janë cekur se, shembull, ku do të bëhet zgjerimi i trotuareve, ndërtimi i urave etj. gjithashtu kam pyetje rreth kësaj pike të rendit të ditës, gjë të cilën e kam ngritur disa herë, përse në Lagjen Babatinca, Stublla dhe Tovërlani, lagje ku jam lind dhe rritë, nuk është investuar fare, mungon ndriçimi, mungojnë rrethojat afër lumit Llap, mungon menaxhimi i mbeturinave, kemi mos pastrim të lumit Llap, mungesë të trotuareve dhe shumë gjërave tjera, kurse banorët e asaj pjese kanë qenë votues të partisë aktuale ndërsa ata banorë tani mendojnë ndryshe. Pastaj nuk vëreja në këtë dokument se është paraparë planifikimi i rregullimit të oborrit të Çerdhes së vetme publike, rregullimi i parkingut pastaj rregullimi i trotuareve rreth parkingut dhe oborrit të Çerdhes çështje kjo e cila është një shqetësim për prindërit të cilët dërgojnë dhe marrin fëmijët e tyre, mandej ndriçimi i pjesës afër Çerdhes dhe rregullimi i asaj pjese e cila ngjason me një vend frike, sidomos natën, si dhe nuk janë planifikuar edhe shumë çështje tjera të ngritura nga ne opozita në seancat paraprake, por si duket përgjigja e juaj çdo herë ka qenë, nuk kemi buxhet të mjaftueshëm, kurse tani po tepron buxheti.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ka këshilltarë tjerë të interesuar për të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo atëherë fjalën e kanë drejtorët e Drejtorive për të marrë fjalën me qëllim të dhënies së sqarimeve dhe arsyetimeve të ndryshme rreth kësaj pike.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, falënderoj këshilltarët parafolës për sugjerimet, vërejtjet dhe diskutimet e tyre në përgjithësi, edhe pse disa prej tyre u munduan të mos bëjnë politikë prapseprap disa prej tyre ishin më shumë politike se sa në realitet, po si do që të jetë i kuptoj gjithsecilin.

Sa i përket propozim buxhetit të Komunës, përkatësisht DSHPMSH konsideroj se në radhë të parë është real dhe këtë e bazoj në atë se që katër vite të këtij mandati të gjitha projektet e parapara janë realizuar, pastaj nuk kemi borxhe publike, dhe buxheti gjithherë ka qenë i shpenzuar 95% – 99%, prandaj edhe për këtë propozim që kemi paravetës e them se do të jetë një buxhet real dhe i realizueshëm.

Dëgjova diskutimet e parafolësve, mirëpo unë dua ndalem vetëm në vërejtjet që janë më esenciale, e them se në projektet dhe shërbimet e planifikuara është një përfshirje e gjerë regjionale, është një propozim i strukturës së propozim projekteve, dhe atë që e tha parafolësi z.Bahri Selimi është e vërtetë ajo përqindje prej 33%, por duke parë strukturën e cila është brendapërbrenda projekteve atëherë domosdoshmërisht është dashtë të orientohemi edhe në ato pika, pra nuk kemi të bëjmë vetëm me kanalizime, por tani për tani i nxjerra disa kalkulime dhe atë, për ndriçim janë rreth 178,000.00€, pastaj për trotuare rreth 301,000.00€, për ura rreth 120,000.00€, për lumenj rreth 280,000.00€, për kolektorë në fazën e dytë 303,000.00€, për ujësjellës rreth 95,000.00€, për kanalizime rreth 360,000.00€, pa përmendur dhjetëra projekte tjera të strukturave tjera. Parafolësja znj.Stublla u ndal vetëm në lagjen e vetë, ne nuk merremi vetëm me një lagje por jemi gjithëpërfshirës dhe ndoshta u ngutët pak sepse në këtë projektbuxhet, në numrin 14 mund ta vëreni edhe ju se është projekti për rrugën “Llapi” etj. Pastaj keni kërkuar të specifikohen projektet për trotuare dhe një gjë të tillë e kemi bërë dhe atë mund t’i lexoni në dokumentin në fjalë (*lexon fshatrat dhe pjesët e qytetit që janë paraparë për investime*), pra kemi llogaritur se me këtë buxhet mund të kryhen këto punë, janë të realizueshme këto segmente. Pastaj ju them se nuk janë partiake këto projekte ashtu siç u tha sepse në qoftëse janë elektorat i joni krejt ata banorë të atyre fshatrave dhe pjesëve tjera të qytetit që i përmenda atëherë i kemi punët mirë dhe nuk po bëjmë fushatë fare, por nuk qëndron ajo sepse ka raste ku brenda shtëpisë ka votues të ndryshëm e lëre brenda një fshati ose lagje. Pastaj sa i përket ndriçimit në rrugën “Llapi” ndoshta këshilltarja në fjalë nuk është e informuar sepse tani veç janë përfunduar procedurat dhe ndriçimi publik në atë rrugë do të përfundoj këtë vit.

Sa i përket asaj që z.Haki Rudari e tha rreth ujësjellësit dhe shtroj pyetje për ujësjellësin në fshatin Orllan, unë them se mund ta shihni në dokument planifikimin për atë çështje, është kodi i ri, dhe unë bashkërisht me Kryetarin e Komunës kemi qenë në bisedime të vazhdueshme dhe tani edhe banorët e atij fshati janë në dijeni shumë mirë se projekti zbatues është duke u hartuar nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal, dhe mu për këtë çështje ne kemi koduar 50,000.00€ sa për fillim por me mundësi që në atë projekt që do të filloj në vitin 2018 Komuna do ta rrisë buxhetin varësisht nga nevojat për ujësjellësin e fshatit Orllan. Duke pasur parasysh këto dhe shumë çështje tjera të rëndësishme, unë ju falënderoj për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja rreth këtij projektbuxheti, në fakt unë kam marrë dhe i kam inkorporuar të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet e juaja gjatë shqyrtimit të KAB, pavarësisht nga kush janë dhënë në muajin qershor të cilat tani jam munduar t’i paraqesë në këtë planifikim buxhetor, dhe të cilat besoj shumë se janë planifikime të realizueshme.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes të Mjedisit (DPUMM), theksoi, fillimisht falënderoj të gjithë parafolësit për kontributin e dhënë gjatë diskutimeve të tyre rreth projektbuxhetit të Komunës për vitin 2017 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2019 – 2020. U mundova t'i evidentoj të gjitha kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet e bëra nga ana e juaj, andaj po e filloj me sqarime dhe arsyetime të nevojshme.

Sa i përket asaj që z.Rafet Llapashtica e ceku rreth emërimit të një projekti në fshatin Bradash, mund t'ju them se në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017 e kam thënë këtu në këtë foltore se është bërë një gabim teknik i cili edhe tani është përsëritur gabimisht, konkretisht fjala është në projektet e planifikuara të DPUMM, nr.7 të rangimit të projekteve ku thuhet asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bradash, duhet të jetë asfaltimi i disa rrugëve në fshatrat Bradash – Dobërdol me theks të veçantë Lagja Revuçi.

Në fshatin Dumnicë janë të parapara disa projekte, fshat ky i cili i ka edhe rreth 7 km, projekte të dorëzuara nga komuniteti, dhe ne kemi në procedurë për këtë vit disa prej projekteve të atij fshati, por janë të planifikuara edhe në vitet e ardhshme disa projekte tjera. Nuk qëndron ajo siç u tha se projekte destinohen në baza politike ngase asnjë projekt nuk planifikohet mbi atë bazë, si dhe lidhur me këtë çështje ju them se unë gjithëherë jam munduar të jem i njëjtë për të gjithë, e kam ndjekë atë agjendë dhe kam vepruar në atë formë, madje ka pasur raste që janë realizuar projekte ku pothuajse shumica e atyre banorëve janë përkrahës të subjekteve tjera, mirëpo unë nuk kam bërë asnjëherë dallime të tilla dhe nuk do të bëjë kurrë. Për fshatin Dumnicë ka disa lagje të cilat kanë sjellë projektet por gjatësia e tyre është bukur e madhe ndoshta më shumë se 1.5 km, mirëpo i kemi të planifikuara dhe besoj se do të realizohen sipas agjendës së planifikuar.

Pastaj u ngritë çështje rreth ndarjes së buxhetit në disa fshatra, siç u tha ka të atilla që janë ndarë vetëm 15,000.00€ nga të hyrat vetanake, çështje për të cilën po e përsërisë sepse besoj që nëse nuk keni harruar njëherë jua kam sqaruar se kemi një Memorandum Bashkëpunimi të nënshkruar mes Kryetarit të Komunës dhe Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës me kohëzgjatje tri vite 2016-2018, dhe për shkak të kodit buxhetor i cili është obligim ligjor që duhet të jetë i hapur për fshatrat Dobërdol, Majac, Herticë, Surdull dhe disa fshatra tjera, ne kemi planifikuar që ato 15,000.00€ të planifikohen në atë kod ngase shuma e mjeteve të zotuar është 100,000.00€. Sa i përket hapësirave publike ku me vendime të Kuvendit të Komunës të viteve paraprake janë caktuar; Sheshi i Dëshmorëve e që fjala është në rrugën "Zahir Pajaziti" në anën e djathtë nga këtu ku jemi përkatësisht në hapësirën mes Postës dhe objekteve banesore, dhe Sheshi Ali Ajeti, unë sërish e përsërisë atë që edhe më herët jua kam thënë, procedurat e tenderimit janë zhvilluar për të dy këto Sheshe përkatësisht për ndërtimin e dy Shtatoreve në fjalë. Vlen të ceket se me rastin e procedimit të tenderit të parë në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, ka qenë vetëm një ofertues dhe për shkak të procedurave ligjore ai tender është anuluar, mirëpo i njëjti brenda një afati të shkurtër është përsëritur, është bërë përzgjedhja dhe tani është duke u realizuar projekti, ndërsa sa i përket Shtatoreve të Heronjve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushefci – Edmond Hoxha, ai është në përfundim e sipër, skulptori është nga Shqipëria i cili është përzgjedhur nga niveli qendror dhe informatat që i kemi janë se në fund të muajit tetor ato Shtatore do të vendosen në hapësirën që e ceka më parë si vend i caktuar për vendosjen e atyre Shtatoreve, kurse obligim i joni si Komunë është vetëm ndërtimi i bazamentit për vendosjen e katër shtatoreve në fjalë. Sa i përket asaj që u potencua rreth ndarjes të një shume të caktuar për vitin 2018 për Bulevardin e qytetit dhe që sërish përcjellët në vitin 2019, ju sqaroj se projekti është hartuar sepse ashtu ka qenë në tender,

Hartim i Projektit, baza ligjore ka qenë, do të mbyllet rruga "Zahir Pajaziti" që nga kryqëzimi i rrugës "Xhemajl Mustafa" deri tek kryqëzimi i rrugës "19 Qershor" përkatësisht afër Teatrit të Qytetit, hapësirë kjo e cili i përmban edhe dy Sheshet në fjalë edhe pse në pjesën e Sheshit Ali Ajeti është e planifikuar të bëhet parking nëntokësorë por që pjesa e sipërme do të mbetet sistem i Sheshit me oazat përkatëse të gjelbërimit.

Po ashtu u potencua edhe çështja rreth disa rrugëve në fshatin Revuç, çështje të cilën disa herë e ka kërkuar këshilltarja e Kuvendit znj.Kumrie Hoti, në atë fshat është realizuar një pjesë e projektit, është e vërtetë se komuniteti i asaj ane në atë kohë ka bërë projektin, gjë e cila ka ndodhur edhe me banorë të komuniteteve tjera në fshatra tjera të Komunës së Podujevës, mirëpo nga shtatori i vitit 2016 asnjë qytetarë – komunitet më nuk ka obligim që me mjete të tyre vetanake të hartojnë projekte ngase hartimi i projekteve tani ka kaluar si obligim i Komunës, kurse në këtë vit janë proceduar dhe janë në fazën tenderuese mbi 2 km asfaltim në fshatin Revuç, dhe po ashtu sa i përket Lagjes Merovci, ajo rrugë është në procedurë për tu rregulluar fillimisht me zhavorr. Gjithashtu u potencua rruga në drejtim të Lagjes Kodraliu në fshatin Llapashticë, mund t'ju them se tani veq është nënshkruar kontrata dhe ajo rrugë do të asfaltohet, kurse tek Lagja Mujaku për këtë vite është e planifikuar të shtrohet me zhavorr. Sa i përket vërejtjeve rreth emërimit të projekteve për lagje apo rrugë konkrete, është shumë e vërtetë ajo që po e thoni ju, mirëpo ato projekte të cilat janë dorëzuar dhe që janë pranuar nga DPUMM dhe që në aspektin profesional dhe teknik i kanë plotësuar kriteret për tu përfshirë në përzgjedhje, unë nuk i kam fajet pse nuk është emëruar projekti, por ashtu siç janë sjellë ashtu edhe i kemi proceduar, shembull, asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Latanc, ngase unë nuk mund të supozoj rrugë ose lagje, mirëpo në ato raste ku ne i kemi pasur projektet të emërtuara ne ashtu edhe i kemi vendosur. Për fund, edhe njëherë ju falënderoj për kontributin dhe sugjerimet e juaja dhe jam i gatshëm çdo herë të bashkëpunoj me ju sa herë që ju shihni të nevojshme.

z.Flakron Gashi, theksoi, në fakt nuk mora fjalën për replikë, por për sqarime, drejtori parafolës z.Durim Salihu për momentin nuk është prezent në sallë, mirëpo ai ose nuk po din ose po bëhet sikurse nuk din, të dyja këto janë të falshme por një gjë nuk mund të falet. Për Sheshet ekzistojnë vendimet e këtij Kuvendi, pikë. Ekziston një vendim për Sheshin e Dëshmorëve Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushëfci, në afërsi të Postës si dhe duhet të ekzistoj edhe një vendim tjetër për Sheshin Ali Ajeti. Nuk mund të bartet Sheshi Ali Ajeti, në qendër dhe t'i bësh dy sheshe në një shesh pa u marrë një vendim tjetër në këtë Kuvend të Komunës ku do të duhej të shfuqizoheshin ato dy vendime të mëparshme, dhe me miratimin e të gjitha palëve të shndërrohej në një shesh, pra nuk mund të bëhet ajo. Pastaj drejtori parafolës e tha se është paraparë që Sheshi Ali Ajeti të bëhet parking nëntokësor, kurse ai plan ende nuk është sjellë në Kuvend për miratim, kjo është utopike. Ky qëndrim nuk është politik sepse kurrë nuk mund ta di se kush më ka votuar e kush jo në qytet, por është qëndrim i logjikshëm, madje mund të logjikoni gjithsecili prej jush.

Mandej kemi çështjen e zgjerimit të rrugëve "Zahir Pajaziti" dhe "Skenderbeu", e që unë i gëzohem nëse bëhet aj zgjerim me gjithë atë infrastrukturë përcjellëse, por këtu implikohen edhe tre faktor tjerë, KEK ose KESK, a ka pasur pajtim dhe a ka plan konkret si dhe harmonizim të qëndrimeve se si do të bëhet shtrirja e kablllove nëntokësore të energjisë elektrike, paramendojeni qendrën e qytetit nga hotel Besiana deri tek Komuna dhe rrugën "Skenderbeu", 3 metra thellë e hapur, kah të lëvizin qytetarët e Podujevës, ose vetëm nëse keni paramenduar të kontraktoni me kontrata të veçanta të shërbimeve sepse ja keni anën për një gjë të tillë, dhe të angazhoni helikopter që të lëvizim gjatë vitit 2018.

Pastaj a janë konsultuar qytetarët – banorët që janë përgjatë vijës së këtyre dy rrugëve, sepse në rast të zgjerimit të rrugës trotuari bartet pothuajse deri në oborre të shtëpive. Unë them se këto dy projekte janë vetëm ashtu, sepse realisht nuk janë menduar dhe nuk janë trajtuar konform interesave të qytetarëve.

z.Haki Rudari, theksoi, dëshiroj t'i them drejtorit të DSHPMSh z.Faik Muçiqit se ne kemi vizituar banorët e fshatit Orllan dhe ata kanë vërejtje rreth gypit të ngushtë të kanalizimit. Sa i përket sqarimeve të drejtorit të DPUMM z.Durim Salihu, projekti për fshatin Dumnice është që nga viti 2014, sinqerisht e them se është e paarsyeshme, dhe pyes, a ka projekte të cilat kanë munguar në vitet 2015 – 2016 dhe të cilat kanë kaluar, unë besoj që ka dhe kjo nuk është në rregull andaj kjo të bënë të kuptosh se vërtetë ka politikë.

Sa i përket specifikimeve që i ceku drejtori i DSHPMSh, sërish e them se nuk kemi specifikime të projekteve, në dokument thuhet, rregullimi i infrastrukturës së varrezave në shumë 65,000.00€ dhe nuk specifikohet, pra kjo praktikë sërish po na përcjellët, pastaj nuk kemi specifikime të projektin, rregullimi i hapësirave publike, ashtu sikur se që nuk ka specifikime për projektin, rregullimi dhe zgjerimi i shtretërve të lumenjve. Sa i përket asaj që u tha se ne nuk nisemi nga lagjet, unë them se për ne qoftë edhe një familje madje edhe një qytetarë ka rëndësi të madhe, andaj nëse ndonjë qytetarë ose ndonjë familje apo edhe qoftë vetëm një qytetarë ka ndonjë kërkesë apo vërejtje ne sigurisht që i shpalosim këtu sepse për ata edhe jemi të zgjedhurit e tyre.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, sqarim parafolësit, projekti nr.3 i DSHPMSh thot, zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap, pra ky është projekt i veçantë, ndërsa në projektin që e kemi të përgjithshëm, zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve, ka të bëjë me 4 - 5 lumenjtë që i kemi, përkatësisht lumi Dumnica vazhdimi nga fshati Sfeçël deri në fshatin Lluzhan edhe lumi Kaqanoll si dhe të tjerë varësisht prej nevojave që i kemi të paraqitura. Po ashtu u tha se nuk janë specifikuar ndërtimi i urave, kurse këtu në dokument shumë qartë thuhet, ndërtimi i urave në Pollatë, Sfeçël, Mirovc, Murgull, Batllavë, Zakutë. Mandej janë disa projekte të përgjithshme siç janë ato për rregullimin e hapësirave publike të cilat kanë të bëjnë me qytetin varësisht planit urbanistik ashtu siç është projekti për rregullimin e stacionit i cili ka të bëjë po ashtu me qytet dhe i cili do të përcaktohet me plan urbanistik, pra janë projekte të cilat nuk kanë kosto të madhe dhe nuk është e domosdoshme të specifikohen secili prej tyre, shembull, kemi rregullimi i rrugëve me zhavorr, janë rreth 100 rrugë, andaj ndoshta nuk është e nevojshme të sjellën në Kuvend të gjitha specifikimet sepse do të bëhej material shumë i gjerë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018 - 2020 e kemi miratuar para rreth dy muajve në këtë Kuvend, dhe në bazë të rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa lidhur me këtë propozim projektbuxhet të Komunës së Podujevës për vitin 2018 dhe prioritetet për vitet 2019 – 2020, si dhe meqë diskutimet rreth kësaj pike të rendit të ditës përfunduan, unë e hedh në votim këtë propozim vendim duke përfshirë edhe propozimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës për vitin 2018, dhe korrigjimin e gabimit teknik të cilin e sqaroj drejtori i DPUMM.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 1 votë kundër dhe 14 vota të përmbajtura u miratua propozimi i projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2018 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2019 – 2020, me korrigjimin e gabimit teknik të propozuar nga drejtori i DPUMM, përkatësisht në listën e projekteve të kësaj Drejtorie, në kolonën 6

ku thuhet, "Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bradash" të vazhdohet me, Lagja e Revuçëve.

Njëkohësisht u miratua edhe propozim Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës për vitin 2018

5. Propozimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha komunale

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para vetë kemi një propozim mjaft të rëndësishëm i cili është hartuar dhe harmonizuar nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht nga Grupi punues për hartimin e saj. Kryesues i Grupit ka qenë drejtori aktual i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z.Avni Fetahu, andaj e ftoj atë për një fjalë hyrëse rreth kësaj propozim rregulloreje.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), në cilësinë e kryesuesit të Grupit punues për hartimin e draft Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, pra vetës keni propozim rregulloren për taksa tarifa dhe gjoha komunale, dokument ky i harmonizuar me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse duke u harmonizuar së fundmi edhe me Ligjin për kundërvajtje si rekomandim ky edhe i nivelit qendror, arsye kjo ndoshta edhe e vonësës së sjelljes së këtij propozimi për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.

Jemi në dijeni se këtij propozimi fillimisht i ka paraprirë diskutimi apo shqyrtimi në këtë Kuvend, pastaj me diskutimin publik me qytetarë, me grupe të interesit dhe përveç tyre mundësia e diskutimit ka qenë edhe përmes Zyrës për informim dhe komunikim me qytetarët përmes postës elektronike për propozime, sugjerime apo edhe vërejtje eventuale në lidhje me këtë dokument. Gjatë diskutimit publik kemi marrë propozime dhe sugjerime nga qytetarët, nga komuniteti i biznesit si dhe nga vetë ju këshilltarët e Kuvendit, dhe të gjitha ato propozime dhe sugjerime të arsyeshme dhe ligjore i kemi inkorporuar në këtë propozim rregullore.

Vlen të theksohet sa i përket bizneseve janë bërë disa ndryshime përkatësisht lehtësira, subjektet e reja afariste, pronare të cilave janë femra lirohen nga taksa komunale për vitin në të cilin regjistrohen dhe për dy vite vijuese, pastaj subjektet e reja prodhuese bujqësore si dhe bizneset e reja me kapital nga diaspora lirohen nga taksa komunale për vitin në të cilin regjistrohen dhe tri vitet vijuese, si dhe gjithashtu ajo që vlen të theksohet është se taksat vjetore komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste si dhe për shërbime profesionale për të gjitha kategoritë, kemi propozuar të lirohen deri në 50%.

Gjithashtu kjo propozim rregullore është korrigjuar edhe në aspektin profesional nga Zyra ligjore e Komunës, andaj presim që edhe Kuvendi i Komunës të mbështet këtë.

z.Hasan Softolli, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrahim këtë propozim rregullore dokument ky i cili krijon lehtësira dhe përkrahje për bizneset.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, e kam marrë shumë seriozisht punën rreth rregullores për taksa tarifa dhe gjoha komunale dhe disa herë e kam ngritë këtë çështje. Fillimisht më vie shumë mirë që ky propozim i kësaj rregulloreje është rikthyer sërish në Kuvend pas një periudhe bukur të gjatë. Krahësuar këtë propozim rregullore me atë e cila aktualisht ende është në fuqi, është një ndryshim jashtëzakonisht shumë pozitiv dhe për këtë më vie shumë mirë,

madje Rregullorja aktuale përveç anës përmbajtësore edhe në aspektin teknik nuk ka qenë në nivel të duhur, mirëpo edhe kjo e cila është sjellë tani për shqyrtim mendoj se i ka tri defekte. Të bënë të dyshosh se Ekzekutivi i Komunës nuk e ka shumë të qartë dallimin mes asaj që është taks dhe asaj që është tatim, dhe për këtë do të lexoj përshkrimin se çfarë thuhet në Udhëzimin Administrativ përkatës se çka është taksa, *‘taksat caktohen në pajtim me parimin e mbulimit të shpenzimeve financiare të materialit shpenzues, koha e shpenzuar, amortizimi i inventarit, përgjegjësisë për regjistrimin, mbajtjen dhe ruajtjen e evidencës dhe të shpenzimeve të tjera’*, pra kjo tregon se për çka mund të vendoset një taksë.

Dy Udhëzimet Administrative, ai 05/2012 dhe 08/2014 janë inkorporuar në tërësi në këtë propozim rregullorë, ndërsa Udhëzimi Administrativ 03/2016 si më duket mua, nuk është marrë për dore fare, Udhëzim të cili po ta kishte nënshkruar Hashim Thaqi ose Ramush Haradinaj do të thoja se nuk i ka pëlqyer Ekzekutiviti të Komunës, por ky Udhëzim është nënshkruar nga Isa Mustafa, andaj mendoj se është dashur të merret parasysh. Tani kam pyetje për drejtorin e DBF z.Isuf Latifi dhe drejtorin e DPKGJ z.Abaz Llugaliu, dhe atë, neni 6 i cili ngarkon bizneset me taksa dhe neni 11 i cili parasheh taksa për transaksione të pronave të paluajtshme, ku e kanë bazën ligjore. Këto dy nene janë tërësisht antiligjore, gjë të cilën e kam thënë edhe herën e parë kur kemi diskutuar për këtë propozim rregullorë, madje ndoshta nuk kam qenë i ashpër kur e kam thënë se këtu plaçkitja është legalizuar, ngase çdo vendim i cili nuk ka bazë ligjore dhe çdo taksë që i merret qytetarit pa bazë ligjore, nuk ka tjetër emërtim përveç plaçkitje, prandaj sërish e them se këto dy nene nuk e kanë bazën ligjore. Nuk jam jurist, por e thash edhe në fillim se këtë çështje e kam marrë seriozisht, i kam konsultuar edhe profesionistë e fushave përkatëse të cilët më kanë siguruar përkatësisht më kanë përforcuar bindjen time se nenet në fjalë janë antiligjore, andaj unë kërkoj nga ju koleg të nderuar, pozitë opozitë sepse taksat janë të gjithëve dhe të njëjtat do t'i paguajmë të gjithë ose nuk do t'i paguajmë asnjë, pra kërkoj që kjo propozim rregullorë, duke përjashtuar nenin 6 dhe nenin 11, të miratohet, pra me këmbëngulësi të higen nenet në fjalë.

Çështja tjetër, i bëjë vërejtje dhe dëshiroj të qartësohem me Ekzekutivin e Komunës, përse nuk e keni zbatuar në vitet 2016 dhe 2017 Udhëzimin Administrativ të Kryeministrit, dhe përse asnjë fjalë e atij Udhëzimi nuk është në këtë propozim rregullorë, udhëzim i cili ka të bëjë me barazinë gjinore, do të thotë pronat të cilat regjistrohen në emër të bashkëshortes apo të gjinisë tjetër, lirohen nga taksat, madje për një vit lirohen edhe nga tatimi në pronë, ngase me këtë Udhëzim ka dashur të stimulohet që edhe gjinia femërore të jetë bashkëpronare në pronat e paluajtshme. Prandaj duke u nisur nga praktika katër vjeçare e këtij mandati, unë droj se ky propozim i kësaj rregulloreje do të kalojë me vota kështu siç është, mirëpo sinqerisht e them se pavarësisht Grupit tim politik të këshilltarëve që i takoj, dhe pavarësisht qëndrimit opozitë - pozitë, nëse kjo ndodh të jeni të sigurt që unë me rrugë ligjore do të rrëzoj këtë vendim, nëse miratohet sepse e di dhe jam i informuar saktësisht cilat janë rrugët ligjore dhe cila është ajo që duhet të ndodh.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, vetëm dëshiroj të përsërisë një çështje të cilën disa herë e kam thënë, çdo vendim i Kuvendit të Komunës dërgohet në Ministrinë përkatëse për vlerësim të ligjshmërisë së tij, dhe një gjë e tillë ndodh gjithherë ku brenda afatit ligjor aktet e Kuvendit dërgohen për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e linjës përkatëse përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, andaj nëse është diçka në

kundërshtim me ligjin atëherë nuk jepet vlerësim pozitiv i ligjshmërisë, kështu që ka kush merret edhe me ligjshmërinë e akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave.

z.Isuf Latifi, drejtor i drejtorisë për Buxhet dhe Financa (DBF), theksoi, e mira është se çdo Vendim, Rregullore ose ndonjë dokument tjetër i cili miratohet në Kuvendet Komunale do t'i nënshtrohet filtrimeve përkatësisht shqyrtimeve administrative të ligjshmërisë së atyre nga ana e nivelit qendror i cili brenda një afati të përcaktuar ligjor jep vlerësimin e ligjshmërisë përkatësisht rekomandimet për secilin akt të Kuvendeve Komunale, prandaj edhe ky akt nëse miratohet sot, do t'ju nënshtrohet këtyre procedurave dhe në rast se kthehet si i paligjshëm sigurisht që do t'ju nënshtrohet rekomandimeve të Ministrive përkatëse, gjë e cila sigurisht që na e lehtëson punën edhe neve si Ekzekutiv i Komunës por edhe këshilltarëve të Kuvendit.

Komunat i realizojnë të hyrat vetanake në bazë të Ligjit për financat e pushtetit lokal, përkatësisht në nenin i cili parasheh kategoritë e të hyrave vetanake të Komunave në fund të atij neni thuhet; edhe të gjitha kategoritë tjera të cilat parashihen nga Komuna, andaj dy çështjet e cekura nga parafolësi, unë i shohë në këtë pikë të ligjit në fjalë, por edhe në qoftë se nuk është në harmoni me ligjin, të kthehet mbrapa.

Çështje tjetër e cila është pozitive në këtë propozim rregullore në krahasim me Rregulloren aktuale është, në nenin 6 janë zvogëluar tarifat për 50%, ndërsa në nenin 11 po ashtu ka zvogëlime por edhe shumë ndryshime thelbësore pozitive për qytetarët. Deri sa në rregulloren aktuale shumat për një transaksion janë 150 € dhe të limituara me m², shembull nëse një shtëpi ka 100 m² shuma e transaksionit është 150 €, nëse ka pas 101 m² kalon në njësi dhe shuma e pagesës arrin në 300 €, ndërsa në propozimin e kësaj rregulloreje për të cilën po debatojmë kjo çështje është rregulluar shumë mirë përkatësisht shuma që duhet paguar për transaksione të tilla do të jetë vetëm 100 €.

Gjithashtu në të gjitha tarifat tjera janë propozuar zbritje – lirime, kështu që kjo rregullore është esenciale dhe shumë më e favorshme se sa rregullorja e vjetër përkatësisht ajo që aktualisht është në fuqi. Pra përveç tjera këto janë dy përparësi që ka kjo propozim rregullore, në nenin 6 dhe në nenin 11, mirëpo sërish po e them se nëse sot miratohet kjo propozim rregullore, e njëjta do të analizohet prej instancave të nivelit qendror lidhur me ligjshmërinë apo jo të saj, dhe shumë shpejt do ta kemi një vlerësim të tillë, e them këtë sepse përveç këtyre dy pikave ndoshta mund të ketë edhe ndonjë nen tjetër i cili mund të mos jetë në harmoni të plotë me Ligjin për financat e pushtetit lokal, ndonjë ligj tjetër apo akt nënligjor, pastaj sigurisht që procedurat vijuese janë të qarta në rastet kur kemi të bëjmë me vlerësime jo ligjore ose përmbushje të rekomandimeve.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), theksoi, nuk dëshiroj të ndalem rreth taksave për transaksione të pronave sepse këtë çështje e sqaroj mjaft mirë drejtori parafolës, mirëpo dëshiroj të jap përgjigje rreth pyetjeve të këshilltarit parafolës z.Lutfi Rexhepit. DPKGJ në përpikëri i zbaton Udhëzimet Administrative 08/2014 përkatësisht 05/2012, ndërsa sa i përket Udhëzimit Administrativ 03/2016 për barazi gjinore dhe regjistrim të bashkëpronësisë në emër të dy bashkëshortëve, të nënshkruar nga Kryeministri Isa Mustafa, ai Udhëzim ka qenë me mandat vetëm 1 vjeçar, kështu që nuk ka mund të inkorporohet në këtë propozim rregullore, por pas kalimit të atij mandati është nxjerrë Urdhëresa e dytë sipas të cilës është vazhduar afati edhe për dy vite tjera për regjistrim të pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, me qëllim të nxitjes së barazisë gjinore edhe sa i përket pronësisë së pronave nga gjinia femërore.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, fillimisht i drejtohem drejtorit parafolës z.Abaz Llugaliu, unë nuk specifikova se çka përmban Udhëzimi Administrativ në fjalë, pastaj unë e thash se Udhëzimet me nr.08/2014 dhe ai me nr.05/2012 janë inkorporuar shumë mirë në këtë propozim rregullorë ngase këto dy Udhëzime e përcaktojnë të drejtën e Komunës për taksë, regjistrimi i pronësisë gjegjësisht për regjistrimin në libra që Komuna ka të drejtën në vjeljen apo përcaktimit të taksës, pra në bazë të transaksionit në shitblerje që është bërë, transaksion që Komuna nuk bënë sepse Komuna nuk kryen shërbime të transaksionit dhe këtë duhet ta kemi të qartë të gjithë, kurse emërtimi nga ana juaj, taksë për transaksion në pronat e paluajtshme, i bie që është një tatim në qarkullim. Unë jam i vetëdijshëm që Udhëzimi Administrativ nr.03/2016 është nënshkruar nga Kryeministri më datë 04 mars 2016 dhe ka hyrë në fuqi pas 7 ditëve dhe ka përmbajtur afatin një vjeçare, mirëpo unë kam informacione se në asnjë rast të vetëm nuk është respektuar ai Udhëzim, madje tani nuk dëshiroj të kthej asgjë në personale por më ka ndodhur personalisht mua kur unë kam dashur të regjistroj pronën në emër të bashkëshortes time më është kërkuar taksa 150 €. Edhe njëherë e përsërisë, i nderuari drejtor i DBF, me keqardhje e them se këto dy nene që e ceka janë antiligjore.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), theksoi, për hir të sqarimit për këshilltarin parafolës, transaksionet apo tarifat të cilat u përmenden nga këshilltari z.Lutfi Rexhepi, i rregullon Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa për aplikim për regjistrim të paluajtshmërisë është një taksë në shumë 20 € e cila paguhet në kadastrë, taksë e cila rregullohet me Udhëzimin Administrativ 03/2016, por jo tarifën komunale, andaj konsideroj se këshilltari në fjalë i ka ngatërruar këto dy çështje.

Do të thotë për çdo kontratë të shitblerjes e cila vie nga Noteri, ku janë dy bashkëpronar automatikisht lirohen prej tarifës në shumë 20 €, por jo për tarifën komunale për të cilën foli dhe e sqaroi mjaft mirë drejtori i DBF.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, mendoj se kemi një paqartësi substanciale me drejtorin parafolës. taksa nuk është vetëm 20 € të cilën ai e ceku, por kjo taksë është për vlerën e transaksionit deri në 10,000.00€, kurse për transaksione në shumë prej 10,000.00€ deri në 30,000.00€ është taksa prej 30€, pastaj prej 30,000.00€ deri në 50,000.00€, taksa është 35€, prej 50,000.00€ deri në 100,000.00€ taksa e cila duhet t'i paguhet Komunës është 50€, ndërsa për transaksionet në vlerë mbi 100,000.00€, për çdo 50,000.00€ tejkallim, paguhet vlera në shumë 30€ por shuma e përgjithshme e taksës që duhet të paguhet nuk mund të tejkaloj shumën mbi 300 €, prandaj të mos krijohet huti tek kolegët këshilltarë të Kuvendi, ngase këto gjëra janë shumë të qarta dhe decive.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që diskutimet e këshilltarëve u kryen, tani e hedh në votim këtë propozim Rregullorë, me vërejtjet e bëra të këshilltarit z.Lutfi Rexhepi.

Mirëpo në vazhdim fjalën e kërkoi këshilltari z.Flakron Gashi, dhe nuk u vazhdua me procesin e votimit.

z.Flakron Gashi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, në çdo moment kur një këshilltarë i Kuvendit të Komunës e parashih që po shkelet Rregullorja e Punës së Kuvendit, ka të drejtë të marrë fjalën goftë kur një dokument hedhet në votim goftë para se të votohet. Prandaj në këtë rast, kur të hedhësh në votim këtë akt, duhesh që specifikisht t'i cekësh çështjet të cilat i përmendi kolegu këshilltar z.Lutfi Rexhepi në emër të Grupit të

këshilltarëve të PDK-së, nëse ato çështje nuk inkorporohen, faktikisht drejtorët e Drejtorive përkatëse po mendojnë se ato gjëra janë në rregull dhe nuk janë për t'i ndryshuar, andaj konsultohuni mes vete edhe ju si Grup i këshilltarëve, sepse pastaj nëse votohet me vërejtjet të cilat i bëri këshilltari z.Lutfi Rexhepi, atëherë na bënë që në seancën e ardhshme ai vendim të kaloj si i tillë. Unë po e rispërsëris se është më mirë dhe në interes të qytetarëve që t'i besojmë më shumë njëri tjetrit, e jo me logjikën se çdo gjë që vie nga opozita është e keqe, këtë e mbështesë edhe në faktin që nuk është i largët një shqetësim të cilin e pata ngritur kundër një vendimi për të cilin e kam thënë se nuk është i ligjshëm i cili ka pas të bëjë me Klubin e Futbollit "Llapi" e që të njëjtin pas dy muajve është dashur të shfuqizojmë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se u dhanë të gjitha sqarimet, atëherë e hedh në votim këtë propozim rregullorë ashtu sipas materialit të propozuar, dhe siç është rekomanduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, do të thotë votimi bëhet pa vërejtjet e z.Lutfi Rexhepit. Në qoftë se eventualisht nga Ministria përkatëse vlerësohet si akt i paligjshëm dokumenti do të rikthehet sërish në Kuvend për rishqyrtim, përkatësisht do të vepruhet sipas rekomandimeve të dhëna.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 10 vota kundër dhe 5 vota të përmbajtura u miratua propozim rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale, sipas materialit të propozuar.

6. Propozimi i vendimit për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës

- Programi i punës për hartimin e Hartës Zonale

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim rreth këtij propozim vendimi. Unë si Kryesues i Kuvendit kam pritur në takim përfaqësuesen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe atë të GIZ, me të cilët kemi diskutuar rreth këtij propozim vendimi. Komuna e Podujevës bënë pjesë në mesin e 5 Komunave të Kosovës ku bashkëfinancuese e këtij projekti është GIZ. Hartimi i Hartës Zonale të komunës është në interes të drejtpërdrejt të qytetarëve, andaj për të filluar me këtë proces është e domosdoshme të ketë vendim nga Kuvendi i Komunës, kështu që detaje tjera të rëndësishme mund t'i gjeni në propozimin e këtij vendimi dhe në programin përkatës si pjesë përbërëse e këtij propozimi, të cilin unë e vlerësoj si në interes të të gjithëve, mirëpo nëse ka të interesuar për të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, duke përfshirë edhe programin e punës për hartimin e Hartës Zonale të bashkëngjitur në këtë material.

7. Të ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0072020/17
Podujevë,
19 shtator 2017**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**